Shpërngulje pa dëshirë	Legjislacioni shqiptar në përgjithësi duke përfshirë edhe Ligjin për Shpronësimet të Republikës së Shqipërisë, nuk e njuh termin Shpërngulje pa dëshirë. Çështjet që lidhen me marrjen e tokës për interes publik janë rregulluar me ligjin nr. 8561 për shpronësimin.	Shpërngulje pa dëshirë e BERZH-it i referohet si shpërnguljes fizike (shpërngulje ose humbje të banesës) ashtu edhe shpërnguljes ekonomike (humbje të aseteve ose burimeve dhe/ose humbje të aksesit në asete apo burime që çon në humbjen e burimeve të të ardhurave apo të mjeteve të jetesës) si rezultat i blerjes së tokës në lidhje me projektin dhe/ose kufizimet në përdorimin e tokës.	Mangësitë në lidhje me shpërnguljen fizike dhe ekonomike, si dhe shpërnguljen e personave që nuk kanë të drejta formale ligjore për tokën dhe strukturat që ata zënë diskutohen më tej në Tabelë.  <b>MANGËSI/KOMENTE:</b> Ligji fokusohet në pronat dhe asetet që mund të shpronësohen ose të zihen përkohësisht, në interes të publikut. Ligji i njuh personat e prekur që kanë të drejta formale ligjore.
Blerja e tokës / kufizimet e aksesit	Ligji rregullon të drejtën e shtetit për të shpronësuar pronat e personave fizikë ose juridikë për interes publik, (neni 1), kundrejt kompensimit të drejtë (neni 2). Gjithashtu, do të parashikohet kompensim për zhvlerësimin e pronave që nuk janë objekt shpronësimi (neni 4). Ligji rregullon zënien e përkohshme të tokës në nenet 27 dhe 28 (p.sh. për punimet e ndërtimit, ngritjen e kantierëve etj.), deri në 2 vjet (neni 33), kundrejt një kompensimi të caktuar (neni 30).	Shpërngulja pa dëshirë ndodh si rezultat i: 1. Blerjes së tokës që përfshin si blerjet e drejtpërdrejta të pronës ashtu edhe blerjet e të drejtave të aksesit (d.m.th. të drejtat e transferimit të pronësisë) 2. Vendosja e kufizimeve që rezultojnë në humbjen e aksesit të njerëzve në asetet fizike ose burimet natyrore.	Duhet të merren parasysh dhe të përcaktohen, rast pas rasti, zgjidhjet për kapërcimin e kufizimeve që shkaktojnë humbjen e aksesit në asetet fizike apo burimet natyrore, për një projekt të caktuar.  <b>MANGËSI/KOMENTE:</b> Kufizimet që shkaktojnë humbjen e aksesit në asetet fizike apo burimet natyrore nuk mbuloohen nga legjislacioni shqiptar.
Fusha e ndikimit (Hartimi i projektit)	Nuk ka kërkesa ligjore në legjislacionin shqiptar për shmangien ose të paktën minimizimin e shpërnguljes fizike dhe/ose ekonomike. Megjithatë, në praktikë, shpërngulja dhe shpronësimi shmangen ose minimizohen gjatë hartimit të projektit, në kontekstin e minimizimit të kostove.	Shqyrtimi i projekteve alternative të realizueshme për të shmangur ose të paktën për të minimizuar shpërnguljen fizike dhe/ose ekonomike, duke balancuar kostot dhe përfitimet mjedisore, sociale dhe ekonomike.	Të garantohet që të studiohet minimizimi i shpërnguljes fizike dhe/ose ekonomike gjatë hartimit të projektit dhe të maksimizohet në masën praktikisht të mundshme. Kurdo që të jetë e mundur, të plotësohen konsideratat për shqyrtimin e çështjeve të shpërnguljes në procesin e VNM-së.  <b>MANGËSI/KOMENTE:</b> Nuk ka kërkesa ligjore në legjislacionin shqiptar për të shmangur ose të paktën për të minimizuar shpërnguljet fizike dhe/ose ekonomike. Megjithatë, në praktikë, shpërngulja dhe shpronësimi shmangen ose minimizohen gjatë hartimit të projektit, në kontekstin e minimizimit të kostove.

Çështja	Normativat Kombëtare	Standarti EBRD	Standarti që duhet të aplikohet/Mungesat dhe/ose Komentet
Procesi i Planifikimit	Në bazë të ligjit për shpronësimin, aplikimi për shpronësim për interes publik, i paraqitur nga përfituesi i shpronësimit në ministrinë kompetente, duhet të përfshijë një listë të detajuar të pronave që do të shpronësohen dhe që preken nga zhvlerësimi, vendndodhjen e tyre, informacionet për individët që kanë të drejta ligjore formale mbi këto prona, duke përfshirë pronarët dhe personat e tretë (neni 10). Pronësia ose të drejtat e tjera formale ligjore mbi tokën dhe strukturat regjistrohen në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (Ligji për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme -7843), nëpërmjet Sistemit Shqiptar të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Të gjitha çështjet në lidhje me të drejtat e pronësisë duhet të zgjidhen para se të bëhet pagesa e shpronësimit; në rast mosmarrëveshjeje, palët e prekura i drejtohen gjykatës për të vendosur se kush do të dëmshpërblehet, që është depozituar në një llogari të veçantë (neni 16). Titullarët me të drejta ligjore formale informohen për procesin e shpronësimit me njoftim të drejtpërdrejtë dhe publikim të aplikimit për shpronësim (nenet 14 dhe 15). Personat e tretë mund të paraqesin kërkesat e tyre për pronat e prekura, brenda një afati prej 15 ditësh nga dita e fundit e publikimit (neni 15).	Vlerësimi bazë social-ekonomik do të bëhet për njerëzit e prekur nga projekti, duke përfshirë ndikimet që lidhen me blerjen e tokës dhe kufizimet në përdorimin e tokës. Vlerësimi do të identifikojë ndikimet brenda kontekstit social të një projekti dhe nevojat dhe të drejtat e njerëzve të prekur dhe do të zhvillojë veprimet e duhura për të minimizuar dhe zbutur ndikimet e shpërnguljes. Do të bëhet regjistrimi i detajuar për: (i) identifikimin e personave që do të shpërngulen nga projekti; (ii) përcaktimin se kush do të ketë të drejtë për kompensim dhe ndihmë; dhe (iii) bërjen e inventarizimit të tokës dhe pronës së prekur. Regjistrimi duhet të marrë parasysh nevojat e përdoruesve të burimeve sezonale të cilët mund të mos jenë të pranishëm në zonën e projektit gjatë kohës së regjistrimit. Kërkesa shtesë zbatohen për konsultimet që përfshijnë popujt indigjenë si dhe individët që i përkasin grupeve vulnerabël, veprime të nevojshme për të siguruar që grupet vulnerabël të mos jenë të pafavorizuara në procesin e shpërnguljes, të jenë plotësisht të informuar dhe të vetëdijshëm për të drejtat e tyre dhe të jenë në gjendje të përfitojnë në mënyrë të barabartë nga shpërngulja, nga mundësitë dhe përfitimet. Këto grupe duhet të identifikohen me anë të procesit të vlerësimit mjedisor dhe social (ashtu siç përshkruhet në KP 1).	Është i nevojshëm realizimi i regjistrimit/studimit dhe zhvillimit të një PVZH/KRT për çdo projekt që kërkon blerje të tokës (shpërngulje fizike ose ekonomike). Ky proces duhet të sigurojë që të gjitha kategoritë e personave të prekur (jo vetëm ata me të drejta formale ligjore) të jenë të informuara dhe të konsultohen në mënyrë të konsiderueshme. Nëse identifikohen grupe vulnerabël gjatë studimeve, mund të jetë e nevojshme të merren masa të veçanta për përfshirjen e tyre në procesin e konsultimit.  <b>MANGËSI/KOMENTE:</b> Legjislacioni shqiptar nuk kërkon zhvillimin e planeve specifike për shpërnguljen/rekuperimin e mjeteve të jetesës, as realizimin e një regjistrimi/studimi social-ekonomik. Të gjithë personat e prekur informohen për shpronësimin e ardhshëm me anë të publikimit të kërkesës për shpronësim. Megjithatë, nuk ka kërkesa për konsultime me personat e prekur apo për miratimin e dispozitave të veçanta për informimin/konsultimin e grupeve vulnerabël. Të gjithë personat që nuk kanë të drejta ligjore formale mbi tokën dhe strukturat e vendosura në zonën e projektit nuk kanë të drejtë për kompensim ose ndihmë për shpërngulje në bazë të ligjit për Shpronësimin dhe për këtë arsye nuk ka një datë përfundimtare për pranueshmërinë.
Data përfundimtare/limit	Kanë të drejtën e kompensimit personat që kanë të drejta ligjore formale mbi tokën dhe strukturat, të regjistruara nga Sistemi i Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Vlerësimet paraprake (inventarizimi) i pronave/pasurive, bëhen përpara se të	Në mungesë të procedurave specifike kombëtare qeveritare, do të përcaktohet data përfundimtare për pranueshmërinë ashtu siç parashikohet nga legjislacioni në fuqi dhe afati kohor i projektit, sipas rastit. Shpesh data përfundimtare më praktike është gjatë vlerësimit apo regjistrimit bazë. Informacioni në	Data e kryerjes së regjistrimit duhet të dakordësohet me agjensinë zbatuese dhe të specifikohet në PVZH/KRT si data e fundit për të drejtën për kompensim dhe shpërngulje për të gjithë personat që nuk kanë të drejta ligjore formale mbi tokën dhe strukturat e vendosura në zonën e projektit. Personat e



Çështja	Normativat Kombëtare	Standarti EBRD	Standarti që duhet të aplikohet/Mungesat dhe/ose Komentet
	dorëzohet në Ministrinë përkatëse kërkesa për shpronësim (neni 10). Vlerësimet përfundimtare bëhen nga komisioni i Ministrisë (neni 17) dhe dorëzohen me propozimin për shpronësim në Këshillin e Ministrave.	lidhje me datën e përfundimit do të dokumentohet mirë dhe do të komunikohet në të gjithë zonën e projektit. Caktimi i një date përfundimtare do të sigurojë qartësi lidhur me përshtatshmërinë për kompensim dhe ndihmë. Personat që lëvizin në vendndodhjen e projektit pas datës përfundimtare nuk kanë të drejtë për kompensim apo për ndonjë ndihmë tjetër.	prekur duhet të informohen për datën përfundimtare.
Marrëveshjet me negociim	Zgjidhjet me negociim inkurajohen nga Ligji për Shpronësimin. Neni 6, thotë se kur pronari pranon t'ia transferojë pronën e vet shtetit, me kushtet (kompensimin) e ofruara nga ministria kompetente, shpronësimi konsiderohet i përfunduar. Pronari duhet ta informojë ministrinë kompetente brenda një afati prej 15 ditësh nga njoftimi (publikimi) nëse e pranon ofertën (neni 16). Nëse nuk arrihet marrëveshja, pas marrjes së vendimit për shpronësim nga Këshilli i Ministrave, pronari i prekur ka të drejtë të ankohet në gjykatë për shumën e dëmshpërblimit (neni 24).	Zgjidhjet me negociim ndihmojnë në shmangien e shpronësimit dhe eliminojnë nevojën për të përdorur autoritetin qeveritar për të shpërngulur njerëzit me forcë. Zgjidhjet me negociim zakonisht mund të arrihen duke ofruar një kompensim të drejtë dhe të përshtatshëm dhe stimuj ose përfitime të tjera për personat ose komunitetet e prekura, si edhe duke zbutur rreziqet e asimetrisë të informacionit dhe fuqisë kontraktuale.	Zgjidhjet me negociim, edhe para fillimit të procesit të shpronësimit (përpara se të bëhet publik aplikimi për shpronësim), duhet të inkurajohen në mënyrë të qartë në PVZH/KRT.
Kompensimi me koston e zëvendësimit	Ligji për Shpronësimin parashikon që kompensimi duhet të jepet mbi bazën e një vlerësimi përfundimtar të pronave të prekura nga Komisioni i Ministrisë së Shpronësimit, ashtu siç përcaktohet në Vendimin e Këshillit të Ministrave (neni 17 dhe 18). Në këtë nen thuhet shprehimisht që duhet të merret parasysh amortizimi i strukturave dhe asetëve. Zënia e përkohshme e pronës është e mundur edhe sipas ligjit për shpronësimin, kundrejt një kompensimi të caktuar (neni 30). Normat e kompensimit jepen nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të Republikës së	Të gjithë personave dhe komuniteteve të shpërngulur do tu ofrohet kompensim për humbjen e asetëve me kosto të plotë zëvendësimi dhe ndihmë tjetër. Kjo synon të rivendosë dhe potencialisht të përmirësojë standardet e tyre të jetesës dhe/ose mjetet e jetesës së personave të shpërngulur në nivelet e para shpërnguljes. Masat mund të bazohen në tokën, burimet, pagat dhe/ose aktivitetet e biznesit. Standardet për kompensim do të jenë transparente dhe koherente brenda projektit. Kompensimi do të sigurohet përpara shpërnguljes ose vendosjes së kufizimeve të hyrjes. Në rastet kur mjetet e jetesës së personave të shpërngulur janë të bazuara në tokë, ose	PVZH/KRT duhet të përshkruajë me hollësi metodën e vlerësimit dhe të specifikojë që kompensimi do të përfshijë koston e regjistrimit në Sistemin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, ose në regjistrin tjetër përkatës, çdo tarifë administrative dhe/ose taksat e transferimit. Gjatë vlerësimeve nuk duhet të merret parasysh amortizimi i strukturave dhe asetëve. <b>MANGËSI/KOMENTE:</b> Ligji nuk përmend në mënyrë specifike kompensimin e kostove për çdo regjistrim dhe për taksat e transferimit. Pavarësisht se standardet e BERZH-it përfshijnë opsionin e kompensimit fizik, është i detyrueshëm zbatimi i standardit të ligjit shqiptar. Sipërfaqja e tokës e nevojshme për stacionin e ri

Çështja	Normativat Kombëtare	Standarti EBRD	Standarti që duhet të aplikohet/Mungesat dhe/ose Komentet
	Shqipërisë, duke u bazuar në transaksionet e fundit të tregut në zonat fqinje.	kur toka është në pronësi kolektive, do të ofrohet kompensim në bazë të tokës, kur është e mundur, duke marrë parasysh kërkesat kohore sezonale dhe bujqësore. Personave të shpërngulur dhe komuniteteve do tu ofrohen mundësi për të nxjerrë përfitime të përshtatshme zhvillimi nga projekti.	të mallrave të propozuar në Lezhë do të kompensohet me para (me çmimin e tregut të lirë).
Kompensimi në natyrë/para	Në rastin e personave të shpërngulur fizikisht, atyre do tu ofrohet të zgjedhin opsionet për një strehim të përshtatshëm me sigurinë e qëndrimit, në mënyrë që ata të mund të shpërngulen ligjërisht pa pasur nevojë të përballen me rrezikun e dëbimit me forcë. Kompensimi në natyrë do të ofrohet në vend të kompensimit në para aty ku është e mundur. Kjo vlen për ata që kanë të drejta zakonore dhe tradicionale të njohura sipas ligjeve të vendit; kërkuesve të cilët, para datës përfundimtare, nuk kanë të drejta ligjore formale për tokën, por që kanë të drejta për këtë tokën ose për këto asete, për shembull, për posedimin të pafavorshëm; dhe atyre që nuk kanë asnjë të drejtë ligjore të njohur apo që pretendojnë tokën që kanë zënë.	Ligji për Shpronësimin nuk specifikon nëse kompensimi ofrohet në para apo në natyrë. Disa dispozita ligjore nënkuptojnë që kompensimi bëhet në para.	Personat e prekur duhet të jenë në gjendje të marrin kompensim në natyrë sa herë që është e mundur, si edhe kur kjo formë kompensimi është zgjedhja e tyre e preferuar.  <b>MANGËSI/KOMENTE:</b> Ligji për Shpronësimin nuk specifikon nëse kompensimi ofrohet në para apo në natyrë. Disa dispozita ligjore nënkuptojnë se kompensimi bëhet në para.
Sigurimi i strehimit/banesës së përshtatshme me sigurinë e qëndrimit	Dekreti nr. 814/2004, i miratuar në bazë të Ligjit për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane, përcakton normat/standardet e banimit dhe sipërfaqen minimale të strehimit për person.	Një strehim apo banesë e përshtatshme mund të matet me cilësinë, sigurinë, përbalueshmërinë, banueshmërinë, përshtatshmërinë kulturore, aksesueshmërinë dhe karakteristikat e vendndodhjes. Strehimi i përshtatshëm duhet të lejojë aksesin në opsionet e punësimit, në tregjet dhe infrastrukturën si edhe në shërbimet bazë, si uji, energjia elektrike, shërbimet higjienike, kujdesin shëndetësor dhe arsimin.  Vendbanimet e reja të ndërtuara për ristirimin e personave të zhvendosur do të ofrojnë, minimalisht, kushtet e jetesës para shpërnguljes dhe aty ku është e	Gjatë zhvillimit të PVZH, kur kompensimi ofrohet në formën e strehimit zëvendësues, duhet të konsultohen personat e prekur për të përcaktuar standardet për strehim të përshtatshëm. Ata që nuk kanë të drejta formale ligjore mbi pronat duhet të shpërngulen në banesa të përshtatshme dhe duhet të kenë sigurinë e qëndrimit, d.m.th. me anë të kontratave të firmosura. Këto kontrata duhet të përfshijnë të gjithë anëtarët e familjes së prekur, për të siguruar që të gjithë ata të jenë të mbrojtur nga shpërnguljet me forcë.  <b>MANGËSI/KOMENTE:</b> Ligji për Shpronësimin nuk parashikon kompensim në natyrë dhe për rrjedhojë dhënien e banesave të

Çështja	Normativat Kombëtare	Standarti EBRD	Standarti që duhet të aplikohet/Mungesat dhe/ose Komentet
		mundur, mundësi të qëndrueshme dhe me kosto efektive për të përmirësuar standardin e jetesës.  Siguria e qëndrimit ekziston nëse personat e shpërngulur mbrohen nga dëbimet me forcë, në masën më të madhe të mundshme.	përshtatshme me siguri pronësie. Ligji për Shpronësimin nuk përfshin asnjë dispozitë në lidhje me vendet e shpërnguljes.
Asistencë tjetër për shpërngulje	Në bazë të ligjit nr. 9355 për ndihmën dhe shërbimet sociale, qytetarët në nevojë të Shqipërisë kanë të drejtë për forma të ndryshme pagesash shërbimesh sociale ose një sërë shërbimesh komunitare (publike dhe private).	Ndihma të tjera për shpërnguljen, të tilla si trajnimi profesional, qasja në kredi dhe mundësi punësimi duhet të vihen në dispozicion në mënyrë të barabartë për burrat dhe gratë dhe duhet tu përshtaten nevojave të tyre. Do të ofrohet ndihma për shpërnguljen e përshtatshme për nevojat e çdo grupi personash të shpërngulur, duke u përqëndruar kryesisht në nevojat e të varfërve dhe të prekurve.	Të përgatitet kompensimi me para i kostove të shpërnguljes ose të organizohet transporti i personave dhe i të gjitha sendeve/aseteve të tyre (të specifikohet në PVZH). Grupet vulnerabël duhet të marrin ndihmë në përputhje me nevojat e tyre specifike. Kjo duhet të bëhet në bashkëpunim me departamentet e shërbimeve sociale (bashkiake apo shtetërore). Minimalisht, grupet vulnerabël duhet të kenë akses në dokumentacion, arsim, shëndetësi dhe shërbime sociale. Duhet të përcaktohet ndihmë tjetër specifike rast pas rasti për një projekt të caktuar.  <b>MANGËSI/KOMENTE:</b> Ligji për Shpronësimin nuk parashikon sigurimin e kostove të shpërnguljes dhe ndihmën specifike të shpërnguljes për grupet vulnerabël.
E drejta për kompensim/ shpërngulje dhe të drejtat në rast shpërngulje fizike	Ligji për Shpronësimin parashikon kompensim për ata që kanë të drejta ligjore formale (Kategoria 1) për tokat, ndërtesat e çdo lloji me natyrë të përhershme (neni 8), përballë një kompensimi të drejtë (neni 2). Ligji Nr. 9232 për Programet Sociale për Strehimin e Banorëve të Zonave Urbane përcakton kuadrin ligjor për zhvillimin e programeve sociale të strehimit në bashkitë shqiptare. Ligji përcakton rregulloret dhe procedurat administrative që do të sigurojnë planifikimin, menaxhimin dhe shpërndarjen e banesave sociale për personat vulnerabël, në përputhje me të ardhurat e tyre dhe nivelin e mbështetjes shtetërore.	Personat: (i) që kanë të drejta ligjore formale për tokën (përfshirë të drejtat zakonore dhe tradicionale të njohura në bazë të ligjeve kombëtare);  (ii) të cilët nuk kanë të drejta ligjore formale për tokën në kohën e regjistrimit, por kanë pretendime për tokën, pretendime që njihen ose janë të njohura nga ligjet kombëtare, do të marrin:  Kompensim për tokën me kosto të plotë zëvendësimi.  Në rastin e shpërnguljes fizike, zëvendësimi i pronës me vlerë të barabartë ose më të lartë me karakteristikë dhe avantazhe ekuivalente ose më të mira të vendndodhjes ose kompensim në para me vlerë të plotë zëvendësimi dhe ndihmë për shpërngulje.	Tu ofrohet ndihmë personave të Kategorisë 2 për të fituar një status ligjor formal përpara shpronësimin (të tokës dhe strukturave), në këtë rast ata kalojnë në Kategorinë 1 dhe kanë të drejtë për kompensim sipas ligjit për Shpronësimin. Ligji i zbatueshëm është: Ligji nr.9482 për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje (legalizimi i strukturave të ngritura në tokë pa titull, me përjashtim të rasteve kur trualli në fjalë është për qëllime publike). Në rastin e legalizimit të strukturave, pronarët e mëparshëm të regjistruar kanë të drejtë për kompensim për tokën në bazë të ligjit nr. 9235 për kthimin dhe kompensimin e pronës. Në rast shpërngulje fizike, minimalisht, duhet të sigurohet një formë strehimi social (me qera të ulët) për Kategorinë 3. Të llogaritet vlera e ndërtimit e strukturave të tyre dhe të ulen qeratë në mënyrë që të korrespondojnë me vlerën e strukturës që ata zotëronin ose të

Çështja	Normativat Kombëtare	Standarti EBRD	Standarti që duhet të aplikohet/Mungesat dhe/ose Komentet
		<p>(iii) të cilët nuk kanë asnjë të drejtë ligjore ose pretendim të njohur për tokën që kanë zënë duhet të marrin:</p> <p>Kompensim për asetet e humbura (të tilla si të korrat, infrastrukturat vaditëse dhe përmirësime të tjera të bëra në tokë) përveç tokës, me kosto të plotë zëvendësimi.</p> <p>Në rast shpërngulje fizike, një zgjedhje të opsioneve për strehim të përshtatshëm me sigurinë e mbajtjes së tokës, në mënyrë që ata të mund të rivendosen ligjërisht pa pasur nevojë të përballen me rrezikun e dëbimit me forcë dhe ndihmave të tjera për shpërngulje.</p>	<p>paguhet kompensim në para. Kjo është zakonisht kategoria më vulnerabël, prandaj është e nevojshme që të ofrohet ndihmë për shpërnguljen (të shihet më poshtë).</p> <p><b>MANGËSI/KOMENTE:</b> Ligji për Shpronësimin nuk njeh ata që kanë pretendime për tokën që u njihet ose që mund të tu njihet në përputhje me ligjet kombëtare (Kategoria 2) dhe ata që nuk kanë asnjë të drejtë ligjore apo pretendim të njohur për tokën (Kategoria 3). Dispozitat e Ligjit NR.9232 Për Programet Sociale për Strehimin e Banorëve të Zonave Urbane duhet të përdoren si bazë për të garantuar që tu jepet strehim i përshtatshëm atyre që janë prekur negativisht nga shpërngulja (zakonisht ata që i përkasin Kategorisë 3). Megjithatë, duhet theksuar që nevoja për banesa sociale në popullatën e përgjithshme është e madhe, ndërsa burimet për ndërtimin e banesave të reja janë të pakta.</p> <p>Duhet të zbatohen standardet e BERZH-it;</p> <p>Konsulenti (me ndihmën e bashkive të prekura) do të shqyrtojë të gjitha llojet e shpërnguljeve të mundshme fizike dhe/ose ekonomike;</p> <p>Gjithsesi, e vetmja shpërngulje fizike dhe/ose ekonomike që mund të verifikohet përsa i përket sipërfaqes së tokës të kërkuar, është për stacionin e ri të mallrave të propozuar në Lezhës;</p> <p>Konsulenti do t'i kushtojë vëmendje të veçantë PAP që mund të ndikohet nga kufizimi i përdorimit të tokës nga kufizimi i kalimeve të paautorizuara. Do të ndërtohen rrugë dytësore, nënkalime dhe mbikalime për të shmangur/minimizuar shpërnguljen ekonomike.</p> <p>Konsulenti do t'i kushtojë vëmendje të veçantë PAP që mund të preket nga sipërfaqja e tokës e kërkuar për ndërtimin e rrugëve dytësore të propozuara, nënkalimeve, mbikalimeve dhe stacionit të ri të mallrave të propozuar në Lezhë.</p>
Grupet	Neni 5 i Ligjit për Programet Sociale për	Do të mbahen parasysh disa veprime të nevojshme	Gjatë regjistrimit është e nevojshme të identifikohen grupet

Çështja	Normativat Kombëtare	Standarti EBRD	Standarti që duhet të aplikohet/Mungesat dhe/ose Komentet
vulnerabël	Strehimin e Banorëve të Zonave Urbane specifikon kategoritë e grupeve vulnerabël që kanë të drejtë për strehim social, pra ata që nuk kanë përfituar nga blerja e apartamenteve shtetërore (privatizimi); ku kryefamiljarë janë gra të divorcuara ose të veja; familjet me një prind; të moshuarit në pension që nuk marrin ndihmë shtetërore; grupet e ndryshme të individëve me aftësi të kufizuara; familje me shumë fëmijë; çiftet e reja, mosha e përbashkët e të cilëve nuk është më e madhe se 55 vjeç; familjet që janë zhvendosur për arsye punësimi; jetimët nën 30 vjeç.	për të siguruar që grupet vulnerabël të mos jenë të pafavorizuara në procesin e shpërnguljes, të jenë plotësisht të informuar dhe të ndërgjegjshëm për të drejtat e tyre dhe të jenë në gjendje të përfitojnë në mënyrë të barabartë nga mundësitë dhe përfitimet e shpërnguljes. Këto grupe duhet të identifikohen me anë të procesit të vlerësimit mjedisor dhe social. Grupet vulnerabël u referohen personave që, për shkak të identitetit gjinor, përkatësisë etnike, moshës, aftësisë së kufizuar, disavantazhit ekonomik ose statusit social mund të ndikohen më negativisht nga ndikimet e projektit sesa të tjerët dhe të cilët mund të jenë të kufizuar në aftësinë e tyre për të kërkuar ose për të patur avantazhe nga përfitimet e projektit. Individët dhe/ose grupet vulnerabël mund të përfshijnë edhe njerëz që jetojnë nën kufirin e varfërisë, personat pa tokë, të moshuarit, gratë kryefamiljare me fëmijë, refugjatët, personat e shpërngulur brenda vendit, pakicat etnike, komunitetet e varura nga burimet natyrore ose persona të tjerë të shpërngulur që mund të mos jenë të mbrojtur nga ligji kombëtar dhe/ose ndërkombëtar.	vulnerabël dhe të vlerësohen nevojat e tyre në lidhje me ndihmën për tu shpërngulur dhe për tu rivendosur, duke përfshirë aksesin në shërbime specifike. Konsultimet mund të mbahen në formën e fokus grupeve në mënyrë që të konsultohen dhe adresohen nevojat e grupeve specifike. Në planifikimin dhe zbatimin e shpërnguljes duhet të përfshihen asistenca sociale dhe shërbimet e tjera të përshtatshme për të siguruar që grupet vulnerabël të kenë akses në të gjitha shërbimet e disponueshme për ta në bazë të ligjeve të Shqipërisë (asistenca sociale, arsimit, kujdesi shëndetësor).  <b>MANGËSI/KOMENTE:</b> Legjislacionin shqiptar nuk parashikon kërkesa të veçanta për organizimin e konsultimeve as asistencë për shpërnguljen e grupeve vulnerabël. Megjithatë, personat e pastrehë kanë të drejtë për ndihmë sociale, e cila përfshin vendosjen në qendra pritje dhe akses në shërbime të tjera të disponueshme sipas ligjeve kombëtare dhe lokale për asistencën sociale.  Duhet të zbatohen standardet e BERZH-it për këtë kategori të PAP; Megjithatë, asnjë person i pastrehë nuk preket nga Projekti;  Nuk nevojiten shpërngulje për projektin e propozuar;  Gjithsesi, Konsulenti (me asistencën e bashkive të interesuara) do të shqyrtojë të gjitha ndikimet e mundshme në grupet vulnerabël.
Pronësi e përbashkët	Burrat dhe gratë kanë të drejta të barabarta në Republikën e Shqipërisë (neni 18 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Ligji nr. 9198 për Barazinë Gjinore në Shoqëri), duke përfshirë mundësinë për të pasur të drejta ligjore formale mbi pronat. Në bazë të Kodit të Familjes së Shqipërisë, nëse të drejtat formale ligjore mbi pronat/pasuritë janë fituar gjatë martesës, ligji supozon që ato ndahen në	Dokumentacioni në lidhje me pronësinë apo banimin, si dokumentet e pronësisë dhe kontratat e qirasë (përfshirë llogaritë bankare të hapura për pagesën e kompensimit), duhet të lëshohen në emër të të dy bashkëshortëve ose të kryefamiljarit të vetëm, sipas rastit. Ndiha të tjera për shpërngulje, të tilla si trajnimi profesional, qasja në kredi dhe mundësi punësimi duhet të vihen në dispozicion të barabartë për burrat dhe gratë dhe tu përshtaten nevojave të	Të specifikohet në PVZH/KRT që kompensimi duhet të ndahet ndërmjet bashkëshortëve sipas dokumentacionit të pronësisë ose sipas Kodit të Familjes në mungesë të dokumentacionit të pronësisë. Sigurohuni që të gjitha programet, përfshirë ato që lidhen me rekuperimin e mjeteve të jetesës, të jenë njëloj të aksesueshme si për burrat ashtu edhe për gratë (të specifikohet në PVZH/KRT).

Çështja	Normativat Kombëtare	Standarti EBRD	Standarti që duhet të aplikohet/Mungesat dhe/ose Komentet
	mënyrë të barabartë mes bashkëshortëve, përveç rasteve kur një marrëveshje tjetër e ndryshme në gjykatë është regjistruar zyrtarisht (nenet 73-76).	tyre.	
Asistencë Ligjore	Nuk ka asnjë kërkesë për ofrimin e ndihmës juridike falas për personat e prekur nga shpronësimi ose shpërngulja, në bazë të ligjit për Shpronësimin. Qeveria e Republikës së Shqipërisë miratoi një ligj për ofrimin e ndihmës juridike falas, i cili hyri në fuqi në prill të vitit 2009, por nuk është bërë shumë përparim në zbatimin e tij.	Njerëzve të shpërngulur do tu ofrohet asistencë ligjore për tu mundësuar atyre të plotësojnë kërkesat administrative përpara blerjes së tokës dhe, nëse është e nevojshme, të kërkojnë dëmshpërblim nga gjykatat.	Personat e prekur duhet të informohen dhe tu sigurohet aksesin në ndihmën juridike falas, qoftë përmes departamenteve bashkiake ose përmes OJQ-ve (të specifikohen në PVZH/KRT). <b>MANGËSI/KOMENTE:</b> Disa komuna kanë departamente që ofrojnë ndihmë juridike falas për qytetarët më të rrezikuar. Përveç kësaj, ka një sërë OJQ-sh në Shqipëri që ofrojnë asistencë ligjore, veçanërisht për grupet më vulnerabel të popullsisë.
Afatet e kompensimit	Nëse është arritur një marrëveshje për kompensim, transferimi i pronës dhe pagesa/sigurimi i kompensimit kryhet brenda 15 ditëve nga njoftimi i pronarit të prekur që pranon ofertën (neni 16). Nëse jo, kompensimi jepet në bazë të një vendimi për shpronësim të Këshillit të Ministrave, brenda një periudhe tre mujore ose pas vendimit të gjykatës (neni 23).	Kompensimi (strehim alternativ dhe/ose kompensim në para) duhet të sigurohet përpara shpërnguljes	PVZH duhet të specifikojë që kompensimi ofrohet para shpërnguljes së personave të prekur.
Humbja e shërbimeve publike	Nuk ka asnjë kërkesë specifike në legjislacionin shqiptar për konsultimin e komuniteteve të prekura në lidhje me humbjen e shërbimeve publike.	Kur një projekt përfshin humbjen e shërbimeve publike, do të ndërmerret një konsultim i rëndësishëm, në përputhje me KP 10, me komunitetin lokal të prekur për të identifikuar dhe, kur është e mundur, për të dakordësuar një alternativë të përshtatshme.	Institucionet e ngarkuara për ngritjen dhe mirëmbajtjen e strukturave specifike publike të cilat preken nga blerja e tokës, duhet të konsultohen me komunitetet lokale se si t'i zëvendësojnë ato (të specifikohet në PVZH). <b>MANGËSI/KOMENTE:</b> Legjislacionin shqiptar nuk parashikon asnjë kërkesë specifike për konsultimin me komunitetet e prekura në lidhje me humbjen e shërbimeve publike. Duhet të zbatohen standardet e BERZH-it për këtë kategori PAP; Konsulentit tashmë e ka marrë në konsideratë këtë çështje. Për zgjidhjen e kësaj çështjeje do të ndërtohen rrugë dytësore, nënkalime dhe mbikalime.

Çështja	Normativat Kombëtare	Standarti EBRD	Standarti që duhet të aplikohet/Mungesat dhe/ose Komentet
E drejta për kompensim/ rekuperim i mirëqënies dhe të drejtat në rast zhvendosjeje ekonomike	Ligji për Shpronësimin parashikon një kompensim për ata që kanë të drejta ligjore formale për tokën, ndërtesat e çdo lloj natyre të përhershme (neni 8), kundrejt një kompensimi të drejtë (neni 2).	<p>Nëse blerja e tokës shkakton humbje të të ardhurave apo të mjeteve të jetesës, Kategoria 1 dhe Kategoria 2, duhet të marrin kompensim për humbjen e aseteve dhe duhet tu jepet akses në asete, me kosto të plotë zëvendësimi, me prona me vlerë të barabartë ose më të madhe ose me kompensim në para me kosto të plotë zëvendësimi.</p> <p>Kategoria 3, duhet të marrë: humbje të aseteve përveç tokës, me kosto të plotë zëvendësimi.</p> <p>Të tre kategoritë duhet të marrin:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-kompensim të koston për rekuperimin e aktiviteteve tregtare diku tjetër;</li> <li>-kompensim për fitimet neto të humbura gjatë periudhës së tranzicionit;</li> <li>-kompensim për koston e transferimit dhe ri-instalimit të impianteve, makinerive apo pajisjeve të tjera;</li> <li>-mbështetje kalimtare duke u bazuar në një vlerësim të arsyeshëm të kohës së nevojshme për tu rikthyer në kapacitetin e tyre për të gjeneruar të ardhura, në nivelet e prodhimit dhe standardet e jetesës;</li> <li>-ndihma të tjera shtesë (lehtësira kreditimi), trajnime ose mundësi punësimi si dhe mundësi për personat e prekur, mjetet e jetesës ose nivelet e të ardhurave të të cilëve janë ndikuar negativisht (pranohen pronarët e bizneseve dhe punonjësit).</li> </ul>	<p>Tu ofrohet ndihmë personave të Kategorisë 2 për të fituar një status ligjor formal përpara shpronësimit (të tokës dhe strukturave), në këtë rast ata kalojnë në Kategorinë 1 dhe kanë të drejtë për kompensim sipas ligjit për Shpronësimin. Ligji i zbatueshëm është: Ligji nr.9482 për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje (legalizimi i strukturave të ngritura në tokë pa titull, me përjashtim të rasteve kur trualli në fjalë është për qëllime publike). Në rastin e legalizimit të strukturave, pronarët e mëparshëm të regjistruar kanë të drejtë për kompensim për tokën në bazë të ligjit nr. 9235 për kthimin dhe kompensimin e pronës.</p> <p>Në rast shpërngulje ekonomike, tu jepet akses atyre që i përkasin Kategorisë 3 në hapësirat e përshtatshme tregtare, me sigurinë e qëndrimit, për të rekuperuar aktivitetet e tyre ekonomike dhe mjetet e jetesës. Të garantohet që të kompensohen menjëherë në para ose në natyrë të gjitha kategoritë (përpara se të humbasin aksesin në pronat/asetet e tyre), në mënyrë që të minimizohet/shmanget humbja e të ardhurave neto dhe nevoja për mbështetje kalimtare. Të organizohet kompensimi me para i kostove të shpërnguljes ose të organizohet transporti i pajisjeve dhe aseteve të tjera. Të lehtësohet aksesin në shërbimet ekzistuese, të cilat mund të ndihmojnë personat e prekur, mjetet e jetesës ose nivelet e të ardhurave të të cilëve ndikohen negativisht për të rekuperuar standardet e tyre të jetesës. Kjo mund të bëhet në bashkëpunim me Shërbimin Kombëtar Shqiptar të Punësimin.</p> <p><b>MANGËSI:</b> Ata që i përkasin Kategorisë 2 dhe Kategorisë 3 nuk kanë të drejtë për kompensim apo ndihmë për rekuperimin e mjeteve të jetesës në bazë të ligjit për Shpronësimin. Gjithashtu, të tre kategoritë nuk kanë të drejtë për koston e rekuperimit të aktiviteteve tregtare, për humbjen e fitimeve neto, për mbështetje kalimtare, për transport të pajisjeve ose asistencë tjetër më specifike. Edhe asistenca për të kompensuar çdo humbje të burimit të zakonshëm të një komuniteti nuk është e</p>

Çështja	Normativat Kombëtare	Standarti EBRD	Standarti që duhet të aplikohet/Mungesat dhe/ose Komentet
			<p>rregulluar në mënyrë specifike nga legjislacioni shqiptar.</p> <p>Duhet të zbatohen standardet e BERZH-it;</p> <p>Konsulenti do t'i kushtojë vëmendje të veçantë PAP që mund të ndikohet nga kufizimi i përdorimit të tokës nga kufizimi i kalimeve të paautorizuara. Do të ndërtohen rrugë dytësore, nënkalime dhe mbikalime për të shmangur/minimizuar kufizimin e përdorimit të tokës (p.sh. km xxx, kmxxx, etj.)</p>
Procedurat e ankimimit	Nuk ka asnjë kërkesë specifike për krijimin e një mekanizmi të pavarur ankimimi, në bazë të Ligjit për Shpronësimet apo të ndonjë legjislacioni tjetër shqiptar. Ligji parashikon të drejtat e shtetasve të prekur (ata me të drejta ligjore formale) për tu ankuar në gjykata kundër vendimit për shpronësim të miratuar nga Këshilli i Ministrave, por vetëm në lidhje me shkallën e dëmshpërblimit që u takon (neni 24).	Do të krijohet sa më shpejt që të jetë e mundur një mekanizëm efektiv për ankimimet në proces. Ai do të jetë në përputhje me këtë KP si edhe dhe me objektivat dhe parimet e KP 10 me qëllim që të pranohen dhe trajtohen në kohën e duhur shqetësimet specifike të personave të shpërngulur dhe/ose anëtarëve të komuniteteve pritëse që kanë të bëjnë me kompensimin dhe shpërnguljen. Ai do të përfshijë një mekanizëm apelimi të menduar për të zgjidhur në mënyrë të paanshme mosmarrëveshjet.	<p>Të përcaktohet një mekanizëm specifik për ankesat në lidhje me projektin në PVZH/KRT. Në varësi të shkallës së projektit ose statusit të përgjithshëm të cënueshmërisë së familjeve të prekura, të përfshihet çdo institucion i disponueshëm në proces, p.sh. avokati i popullit, grupet e të drejtave të njeriut, etj.</p> <p><b>MANGËSI/KOMENTE:</b> Në praktikë ata me të drejta ligjore formale vihen në dijeni që do të bëhet shpronësimi, gjatë fazës së punimeve në terren dhe gjatë mbledhjes së dokumentacionit të pronësisë, në përgatitjen e kërkesës për shpronësim.</p>
Përhapja e informacionit dhe konsultimi publik	<p>Në bazë të nenit 14 të ligjit për Shpronësimin, ata që kanë të drejta formale ligjore njoftohen drejtpërdrejt për pranimin e kërkesës për shpronësim nga Ministria kompetente (brenda 10 ditësh) dhe ftohen të negociojnë paketën e kompensimit.</p> <p>Në bazë të nenit 15, aplikimi botohet edhe në Fletoren Zyrtare, në një gazetë me shpërndarje në nivel kombëtar dhe në një gazetë vendore për një periudhë njëjavore.</p>	Informacioni që përmbahet në PVZH dhe/ose KRT do të përmblihet për tu bërë publik në mënyrë që të garantojë që njerëzit e prekur të kuptojnë procedurat e kompensimit dhe të dinë se çfarë parashikohet në faza të ndryshme të projektit. Konsultimet do të vazhdojnë gjatë zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të pagesës së kompensimit dhe shpërnguljes në mënyrë që të arrihen rezultate në përputhje me objektivat e kësaj PR.	<p>Planet për konsultim me të gjithë personat e prekur nga projekti, duke përfshirë komunitetet pritëse, duhet të dakordësohen me ta dhe të përfshihen në PVZH/KRT.</p> <p><b>MANGËSI/KOMENTE:</b> Ligji për Shpronësimin nuk kërkon që të mbahen konsultime publike me asnjë kategori personash të prekur nga projekti, para shpronësimit. Pasi të ketë filluar procesi i shpronësimit, konsultohen vetëm ata me të drejta ligjore formale me anë të procesit të negociatave individuale.</p> <p>Megjithatë, Ligji Shqiptar “Për VNM” kërkon dëgjesa publike përpara dhënies së Lejes Mjedisore;</p> <p>Konsulenti (me ndihmën e bashkive të interesuara) do të shqyrtojë të gjitha llojet e pretendimeve mbi pronësinë e sipërfaqeve të tokës që janë prekur.</p>



Çështja	Normativat Kombëtare	Standarti EBRD	Standarti që duhet të aplikohet/Mungesat dhe/ose Komentet
Monitorimi	Në bazë të legjislacionit shqiptar, nuk ka kërkesa për monitorimin e procesit të shpronësimit/shpërnguljes/rifitimit të mjeteve të jetesës.	Monitorimi i procesit të shpërnguljes dhe rifitimit të mjeteve të jetesës do të kryhet në përputhje me KP 1 dhe duhet të përfshijë pjesëmarrjen e palëve kryesore të interesit, siç janë komunitetet e prekura.	Përcaktoni treguesit dhe mekanizmat monitorues në PVZH/KRT. <b>MANGËSI/KOMENTE:</b> Duhet të zbatohen standardet e BERZH-it.

## 3.2 Shtojca 3.2: Normativat për përmbajtjen e raportit të VNM.

### Normativat BE

Në përputhje me Direktivën për VNM 2011/92/BE e ndryshuar nga Direktiva 2014/52/BE, përmbajtja e një raporti VNM përfshin <sup>6</sup>

1. Një përshkrim të projektit, duke përfshirë në veçanti:
  - a. Një përshkrim të vendndodhjes së projektit;
  - b. Një përshkrim të karakteristikave fizike të të gjithë projektit, duke përfshirë, aty ku është e nevojshme, punimet e nevojshme të prishjes, dhe kërkesat për përdorimin e tokës gjatë fazave të ndërtimit dhe asaj operative;
  - c. një përshkrim të karakteristikave kryesore të fazës operative të projektit (në veçanti për çdo process prodhimi), për shembull, kërkesën për energji dhe energjinë e përdorur, natyrën dhe sasinë e materialeve dhe burimeve natyrore të përdorura (përfshirë ujin, tokën, terrenin dhe biodiversitetin);
  - d. një vlerësim, sipas llojit dhe sasisë, të mbetjeve dhe shkarkimeve të prishme (të tilla si ndotja e ujit, ajrit, tokës dhe nëntokës, zhurma, dridhja, drita, nxehtësia, rrezatimi) dhe sasi të dhe llojet e mbetjeve të prodhuara gjatë fazave të ndërtimit dhe atyre operative.
2. Një përshkrim të alternativave të arsyeshme (për shembull në aspektin e dizajnit të projektit, teknologjisë, vendndodhjes, madhësisë dhe shkallës) të studiuara nga zhvilluesi, të cilat janë të rëndësishme për projektin e propozuar dhe për karakteristikat e tij specifike, si dhe një tregues të arsyeve kryesore për përzgjedhjen e opsionit të zgjedhur, duke përfshirë një krahasim të efekteve mjedisore.
3. Një përshkrim të aspekteve kryesore të gjendjes aktuale të mjedisit (skenari bazë) dhe një profil të evolucionit të mundshëm të tij pa zbatimin e projektit për aq sa mund të vlerësohen ndryshimet natyrore në krahasim me skenarin bazë me përpjekje të konsiderueshme duke u bazuar në disponueshmëria e informacionit mjedisor dhe njohurive shkencore.
4. Një përshkrim të faktorëve të specifikuar në nenin 3(1) që mund të ndikohen ndjeshëm nga projekti: popullsia, shëndeti i njeriut, biodiversiteti (për shembull fauna dhe flora), toka (për shembull konsumi i tokës), dheu (për shembull lëndë organike, erozioni, ngjeshja, papërshkueshmëria), uji (për shembull ndryshimet hidromorfologjike, sasia dhe cilësia), ajri, klima (për shembull emetimet e gazeve serrë, ndikimet që lidhen me përshtatjen), asetet materiale, trashëgimia kulturore, duke përfshirë aspektet arkitekturore dhe arkeologjike, dhe peizazhi.
5. Një përshkrim i efekteve të rëndësishme të mundshme të projektit në mjedis që vijnë ndër të tjera nga:
  - a. ndërtimi dhe ekzistenca e projektit, duke përfshirë, aty ku është e nevojshme, punimet e prishjes;
  - b. përdorimi i burimeve natyrore, në veçanti i tokës, terrenit, ujit dhe biodiversitetit, duke marrë parasysh sa më shumë që të jetë e mundur disponueshmërinë e qëndrueshme të këtyre burimeve;
  - c. emetimi i ndotësve, zhurmës, dridhjeve, dritës, nxehtësisë dhe rrezatimit, krijimi i shqetësimeve dhe asgjësimi dhe rikuperimi i mbetjeve;

<sup>6</sup> Annex IV of the Directive 2014/52/EU

- d. rreziqet për shëndetin e njeriut, trashëgiminë kulturore ose mjedisin (për shembull për shkak të aksidenteve ose fatkeqësive);
  - e. grumbullimin e efekteve me projekte të tjera ekzistuese dhe/ose të miratuara, duke marrë parasysh çdo problem mjedisor ekzistues në lidhje me zonat me rëndësi të veçantë mjedisore që mund të preken ose në lidhje me përdorimin e burimeve natyrore;
  - f. ndikimi i projektit mbi klimën (për shembull natyra dhe sasia e emetimeve të gazeve serrë) dhe cenueshmëria e projektit ndaj ndryshimeve klimatike;
  - g. teknologjitë dhe substancat e përdorura.
6. Përshkrimi i efekteve të mundshme të konsiderueshme mbi faktorët e specifikuar në nenin 3(1) duhet të mbulojë efektet e drejtpërdrejta dhe çdo efekt jo të drejtpërdrejtë, dytësor, kumulativ, ndërkuftar, afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë, të përhershëm dhe të përkohshëm, efektet pozitive dhe negative të projektit. Ky përshkrim duhet të marrë parasysh objektivat e mbrojtjes së mjedisit të vendosura në nivel të Bashkimit Europian ose të Shteteve Anëtare që janë të rëndësishme për projektin.
7. Një përshkrim i metodave ose evidencave parashikuese, të përdorura për të identifikuar dhe vlerësuar efektet e rëndësishme në mjedis, duke përfshirë të dhënat e hollësisht për vështirësitë (për shembull mangësitë teknike ose mungesën e njohurive) të konstatuara gjatë përpilimit të informacionit të kërkuar dhe për pasiguritë kryesore të përfshira.
8. Një përshkrim i masave të parashikuara për të shmangur, parandaluar, reduktuar dhe kur ose, nëse është e mundur, për të kompensuar çdo efekt negativ të konsiderueshëm të identifikuar në mjedis dhe, nëse shihet e arsyeshme, të masave të mundshme monitoruese të propozuara (për shembull përgatitja e një projekti pas analizës). Ky përshkrim duhet të shpjegojë shkallën në të cilën shmangen, parandalohen, zvogëlohen ose kompensohen efektet negative me rëndësi në mjedis dhe duhet të mbulojë si fazën e ndërtimit ashtu edhe atë operative.
9. Një përshkrim i efekteve negative të rëndësishme që parashikohen të ketë projekti në mjedis që vijnë nga vulnerabiliteti i projektit ndaj rreziqeve për aksidente dhe/ose fatkeqësi të rëndësishme për projektin në fjalë. Për këtë qëllim mund të përdoren informacionet përkatëse të disponueshme dhe ato që janë marrë nga raportet e vlerësimeve të rrezikut në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Europian si Direktiva 2012/18/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit ose Direktiva e Këshillit 2009/71/Euratom ose nga vlerësimet përkatëse të kryera në përputhje me legjislacionin kombëtar, nëse përmbushen kërkesat e kësaj direktive. Nëse është e përshtatshme, ky përshkrim duhet të përfshijë masat e parashikuara për të parandaluar ose zbutur efektet negative të rëndësishme të këtyre ngjarjeve në mjedis si edhe detaje për përgatitjen dhe reagimin e propozuar ndaj këtyre emergjencave.
10. Përmbledhje jo-teknike e informacionit të dhënë sipas pikave 1 deri në 8.
11. Listë referimi që detajon burimet e përdorura për përshkrimet dhe vlerësimet e përfshira në raport.

#### **Normativat Kombëtare**

VKM 912/2015 “Për metodologjinë e VNM” parashikon përmbajtjen e një raporti të plotë të VNMS-së, i cili përfshin:

- Përmbledhjen jo-teknike;

- Klasifikimin e projektit të propozuar në përputhje me VNMS-në paraprake (të thjeshtuar) ose të plotë;
- Përshkrimin teknik të teknologjisë, strukturave dhe aktiviteteve të projektit;
- Vendndodhjen e projektit dhe alternativat e marra në konsideratë;
- Kuadrin e normativave;
- Informacionin për informimin dhe konsultimin publik .
- Informacionin për linjat bazë biofizike dhe social-ekonomike për zonën e projektit;
- Ndikimet e mundshme të aktiviteteve të projektit dhe masat zbutëse;
- Nënvizimin e kontekstit ndërkufitar të aktiviteteve të projektit (nëse ka);
- Përshkrime të hollësishme rreth përdorimit të qëndrueshëm të energjisë dhe burimeve natyrore;
- Kushtet e shëndetit dhe të punës dhe rreziku i mundshëm nga aksidentet dhe masat parandaluese zbutëse;
- Pjesëmarrja e publikut në procesin e vendimmarrjes;
- Angazhimi i aktorëve të mundshëm, përfshirë popullsinë e prekur, OJQ-të, agjensitë/organet shtetërore zyrtare apo shkencore që mbulojnë çështje të ndryshme (trashëgimia kulturore, pyjet dhe kullotat, objektet e infrastrukturës, planifikimi urban, etj.).

#### **Standardet e BERZH-it**

Në bazë të Raportit Fillestar dhe Termave të Referencës të miratuara nga BERZH, projekti i propozuar klasifikohet si i Kategorisë A në përputhje me kriteret e BERZH-it. Si i tillë, ai duhet të përmbushë Kërkesat e Performancës (PR) të BERZH-it si standarde reference në lidhje me strategjitë mjedisore dhe sociale (shih seksionin 3.2).

Projekti është klasifikuar si i Kategorisë A në përputhje me kriteret e BERZH-it dhe si i tillë, kërkohet një proces i posaçëm vlerësimi me pjesëmarrjen e aktorëve të përfshirë në përputhje me Standardet e BERZH-it. Procesi duhet të përfshijë:

- Një Vlerësim të plotë të Ndikimit Mjedisor dhe Social në përputhje me KP 1 Menaxhimi i Vlerësimit Mjedisor dhe Social dhe KP 10 Përhapje e Informacionit dhe Angazhimi i Palëve të Interesit;
- Një ekzaminim i alternativave të realizueshme teknikisht dhe financiarisht dhe arsyet për përzgjedhjen e alternativës (KP 1);
- VNMS gjithashtu duhet të identifikojë çështjet që lidhen me rreziqet e mundshme për shëndetin dhe sigurinë e komunitetit, si dhe për punën dhe kushtet e punës (KP 2 dhe 4);
- Implementimi brenda VNMS-së i KP 3 (Parandalimi dhe Zvogëlimi i Ndotjes);
- Një vlerësim i çështjeve të shpërnguljes së pavullnetshme në përputhje me KP 5;
- Përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore dhe mbrojtja e biodiversitetit (KP 6);
- Krijimi i mundësive për popujt indigjenë që të marrin pjesë dhe të përfitojnë nga aktivitetet e lidhura me projektin (KP 7);
- Vlerësimi i ndikimeve në trashëgiminë kulturore në përputhje me (KP 8)

### **3.3 Shtojca 3.3: Matrica e fushëveprimit të VNM-së**

Tabela më poshtë përbën matricën e fushëveprimit të VNMS-së, ashtu siç paraqitet në raportin e fushëveprimit të VNMS-së.

Tabela 3.2\_ Matrica e fushëveprimit

Çështjet VNMS	Burimi i ndikimit	Receptorët	Ndikimi	Ndjeshmëritë e receptorëve kryesorë	Kuadri Brenda/Jashtë	Arsyetimi për kuadrin Në/Jashtë
Ajri	Aktivitetet e ndërtimit dhe transportit	Banorët vendas; Fauna; Fuqia punëtore	Stres për banorët vendas dhe faunën	E gjithë zona e punimeve	Jashtë	Përfituesi do të zbatojë Praktikën e Mirë Ndërkombëtare (PMN) në aktivitetet e tyre të ndërtimit si pjesë e Sistemit të tyre të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (SMMS).
Ajri	Punimet	Banorët vendas; Fauna	Stres për banorët vendas dhe faunën	E gjithë zona e punimeve	Jashtë	Trenat do të përdorin karburant të cilësisë së mirë
Zhurmat dhe dridhjet	Aktivitetet e ndërtimit dhe transportit	Fauna	Stres për faunën	Km 136 deri në km 140	Brenda	Kuadri në lidhje me efektet e mundshme në faunën e MNR të Liqenit të Shkodrës
Zhurmat dhe dridhjet	Aktivitetet e ndërtimit dhe transportit	Banorët vendas; Fuqia punëtore	Stres për banorët vendas	E gjithë zona e punimeve	Jashtë	Përfituesi do të zbatojë Praktikën e Mirë Ndërkombëtare (PMN) për aktivitetet e tyre të ndërtimit si pjesë e VNMS -së së tyre.
Zhurmat dhe dridhjet	Fazat operative	Banorët vendas	Stres për banorët vendas	Mamurras, Lezhë, Shkodër	Brenda	Kuadri në lidhje me efektet e mundshme për banorët lokalë
Gjeologjia dhe gjeomorfologjia	Rrëshqitje	Hekurudha	Dëmtime fizike për hekurudhën	Nga km 25-50, km 60-68, dhe 70- 90, nënstruktura hekurudhore ndikohet nga rrëshqitjet	Brenda	Kuadri përpara i takon identifikimit të zonave me rrezik të lartë
Gjeologjia dhe gjeomorfologjia	Lëngëzim i tokës	Hekurudha	Dëmtime fizike për hekurudhën	Km 101 deri në 103; Zonat me aktivitet	Brenda	Linja hekurudhore ndodhet afër një zone me intensitet të lartë sizmik

Çështjet VNMS	Burimi i ndikimit	Receptorët	Ndikimi	Ndjeshmëritë e receptorëve kryesorë	Kuadri Brenda/Jashtë	Arsyetimi për kuadrin Në/Jashtë
				sizmik me nivele të larta të ngopjes së tokës		
Tokat	Derdhje aksidentale të vajrave ose kimikateve nga motorët e ndërtimit dhe transportit	Zonë karstike	Ndotja e tokës nga derdhjet aksidentale të vajrave për shkak të masave të pakta parandaluese dhe kontrollit të ndotjes	Km 120 deri në km 140	Jashtë	Përfituesi do të aplikojë Praktikën e Mirë Ndërkombëtare (PMN) për aktivitetet e tyre të ndërtimit në kuadër të VNMS së tyre.
Tokat	Ngjeshja e tokës nga motorët e ndërtimit dhe transportit	Tokë bujqësore	Përkeqësimi i cilësisë së tokës nga ngjeshja/kompaktimi	Shirit pune në të dyja pjesët e hekurudhës; Stacioni i ri Lezhë; Çdo rrugë e mundshme hyrje	Brenda	Kuadri përsa i takon ruajtjes së cilësisë së tokave bujqësore
Tokat	Çdo rrugë e mundshme hyrje	Tokë bujqësore	Përkeqësimi i cilësisë së tokës nga ngjeshja/kompaktimi	Për tu përcaktuar	Brenda	Kuadri përsa i takon ruajtjes së cilësisë së tokave bujqësore
Tokat	Sipërfaqja e tokës bujqësore e nevojshme për ndërtimin e	Tokë bujqësore	Humbje e tokës bujqësore, përfshirë pjesën e sipërme të	Vendndodhja e zonës së propozuar për stacionin e ri të Lezhës	Brenda	Kuadri përsa i përket heqjes së <i>shtresës së sipërme</i> të tokës dhe ripërdorimit të saj për përmirësimin e cilësisë së tokës bujqësore.

Çështjet VNMS	Burimi i ndikimit	Receptorët	Ndikimi	Ndjeshmëritë e receptorëve kryesorë	Kuadri Brenda/Jashtë	Arsyetimi për kuadrin Në/Jashtë
	stacionit të ri të Lezhës		sipërfaqes			
Tokat	Derdhje aksidentale të vajrave ose kimikateve nga motorët e ndërtimit dhe transportit	Zona bujqësore dhe urbane	Ndotja e tokës nga derdhjet aksidentale të vajrave për shkak të masave të pakta parandaluese dhe kontrollit të ndotjes.	E gjithë zona e punimeve	Jashtë	Përfituesi do të zbatojë Praktikën e Mirë Ndërkombëtare (PMN) në aktivitetet e tyre të ndërtimit si pjesë e Sistemit të tyre të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (VNMS).
Tokat	Derdhje aksidentale të vajrave ose kimikateve nga motorët e ndërtimit dhe transportit	Ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësorë	Ndotje e ujrave nëntokësorë dhe sipërfaqësorë	E gjithë zona e punimeve	Jashtë	Përfituesi do të zbatojë Praktikën e Mirë Ndërkombëtare (PMN) në aktivitetet e tyre të ndërtimit si pjesë e Sistemit të tyre të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (SMMS).
Ujërat nëntokësorë	Derdhje aksidentale të vajrave ose kimikateve nga motorët e ndërtimit dhe transportit	Ujërat nëntokësorë	Ndotje e ujrave nëntokësorë	E gjithë zona e punimeve	Jashtë	Përfituesi do të zbatojë Praktikën e Mirë Ndërkombëtare (PMN) në aktivitetet e tyre të ndërtimit si pjesë e Sistemit të tyre të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (VNMS).
Ujërat nëntokësorë	Derdhje aksidentale të vajrave ose	Shtresa ujëmbajtëse të përdorura për	Ndotje e ujrave nëntokësorë	Zonat e rimbushjes (akuiferët e vendosur): kalimet e shtratit të	Brenda	Kuadri në lidhje me ndotjen e akuiferëve të përdorur për furnizimin me ujë të pijshëm dhe



Çështjet VNMS	Burimi i ndikimit	Receptorët	Ndikimi	Ndjeshmëritë e receptorëve kryesorë	Kuadri Brenda/Jashtë	Arsyetimi për kuadrin Në/Jashtë
	kimikateve nga motorët e ndërtimit dhe transportit	furnizimin me ujë të pijshëm; Konsumatorët e ujit të pijshëm		lumit Mat; Akuiferi i Sipërm i Shkodrës; Akuiferi i Koplikut; Zonat karstike		që janë të mbuluar nga depozitime të depërtueshme
Ujërat nëntokësorë	Derdhje aksidentale të vajrave ose kimikateve nga motorët e ndërtimit dhe transportit	Ujëra sipërfaqësorë	Ndotje e ujrave sipërfaqësorë	Ujërat sipërfaqësore që ushqehen nga ujërat nëntokësore: Liqeni i Shkodrës, monumentet hidrike të Syri Zi, Syri Sheganit)	Brenda	Kuadri në lidhje me ndotjen e trupave të caktuar ujorë sipërfaqësorë
Ujërat sipërfaqësorë	Derdhje aksidentale të vajrave ose kimikateve nga motorët e ndërtimit dhe transportit	Cilësia e Ujrave Sipërfaqësorë; Flora/fauna ujore	Ndotje e ujrave sipërfaqësorë	Ujërat sipërfaqësorë që kalojnë	Jashtë	Përfituesi do të zbatojë Praktikën e Mirë Ndërkombëtare (PMN) në aktivitetet e tyre të ndërtimit si pjesë e SMMS -së së tyre.
Ujërat sipërfaqësorë	Derdhje aksidentale të vajrave ose kimikateve nga motorët e ndërtimit dhe transportit	Cilësia e Ujrave Sipërfaqësorë; Flora/fauna ujore	Ndotje e ujrave sipërfaqësorë	Ëtëter bodies receiving rivers and streams – Shkodra Lake Trupat ujorë që presin lumenjtë dhe përrenjtë – Liqeni i Shkodrës	Jashtë	Përfituesi do të zbatojë Praktikën e Mirë Ndërkombëtare (PMN) në aktivitetet e tyre të ndërtimit si pjesë e Sistemit të tyre të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (SMMS).
Përmytjet	Ndërtim dhe funksionim	Linja hekurudhore	Hekurudhë e dëmtuar dhe/ose e përmytur	Nga Lezha deri në Baqel	Brenda	Kuadri në lidhje me efektet e mundshme të përmytjes në hekurudhë.

Çështjet VNMS	Burimi i ndikimit	Receptorët	Ndikimi	Ndjeshmëritë e receptorëve kryesorë	Kuadri Brenda/Jashtë	Arsyetimi për kuadrin Në/Jashtë
Biodiversiteti tokësor	Aktivitete ndërtimi dhe transporti	Flora tokësore	Dëmtim i florës dhe i bimësisë tokësore	E gjithë zona e punimeve	Jashtë	Përfituesi do të zbatojë Praktikën e Mirë Ndërkombëtare (PMN) në aktivitetet e tyre të ndërtimit si pjesë e Sistemit të tyre të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (SMMS).
Biodiversiteti tokësor	Aktivitete ndërtimi dhe transporti	Flora tokësore	Dëmtim i florës dhe i bimësisë tokësore	Km 135 deri në km 140	Brenda	Kuadri në lidhje me efektet e mundshme në zonën e pyllëzuar që mbulon fushën karstike në veri të Bajzës.
Biodiversiteti Ujor	Aktivitete ndërtimi dhe transporti	Fauna dhe flora ujore	Dëmtim i biodiversitetit ujor	Km 138 deri në km 140	Brenda	Kuadri në lidhje me efektet e mundshme në cilësinë e ujit të liqenit të Shkodrës
Biodiversiteti Ujor	Aktivitete ndërtimi dhe transporti; Zhurmë	Zogjtë shtegëtarë	Stres për zogjtë shtegëtarë	Km 138 deri në km 140	Brenda	Kuadri në lidhje me efektet e mundshme ndaj shpendëve shtegtarë të MNR-së të Liqenit të Shkodrës
Ndryshimet klimaterike	Aktivitete ndërtimi dhe transporti	Linja hekurudhore	Hekurudha e përmytur	E gjithë zona e punimeve	Jashtë	Përfituesi do të zbatojë Praktikën e Mirë Ndërkombëtare (PMN) në aktivitetet e tyre të ndërtimit si pjesë e Sistemit të tyre të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (SMMS).
Ndryshimet klimaterike	Funksionim	Linja hekurudhore	Hekurudha e dëmtuar dhe/ose e përmytur	Nga Lezha deri në Baqel	Brenda	Kuadri në lidhje me efektet e mundshme të përmytjes në hekurudhë
Trafiku	Aktivitete ndërtimi dhe transporti;	Banorët vendas; Përdoruesit e makinave	Ndërpreje trafiku	Kalimet në nivel – rrugë dytësore dhe tretësore	Jashtë	Përfituesi do të zbatojë Praktikën e Mirë Ndërkombëtare (PMN) në aktivitetet e tyre të ndërtimit si pjesë e

Çështjet VNMS	Burimi i ndikimit	Receptorët	Ndikimi	Ndjeshmëritë e receptorëve kryesorë	Kuadri Brenda/Jashtë	Arsyetimi për kuadrin Në/Jashtë
						Sistemit të tyre të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (SMMS).
Trafiku	Aktivite ndërtimi dhe transporti;	Banorët vendas; Përdoruesit e makinave	Ndërpreje trafiku	Kalimet në nivel – rrugë kombëtare	Brenda	Kuadri në lidhje me efektet e mundshme në trafikun e rrugëve kombëtare
Infrastruktura	Aktivite ndërtimi;	Infrastruktura nëntokësore (tubacionet e ujit, kabllot elektrike, etj.)	Dëmtime në infrastrukturë	Për tu përcaktuar	Jashtë	Përfituesi do të zbatojë Praktikën e Mirë Ndërkombëtare (PMN) në aktivitetet e tyre të ndërtimit si pjesë e Sistemit të tyre të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (SMMS).
Sistemi i kullimit dhe vaditjes	Aktivite ndërtimi dhe transporti;	Pronarët e tokës, Banorët vendas	Dëmtime në sistemin e kullimit dhe të vaditjes	E gjithë zona e punimeve	Jashtë	Përfituesi do të zbatojë Praktikën e Mirë Ndërkombëtare (PMN) në aktivitetet e tyre të ndërtimit si pjesë e Sistemit të tyre të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (SMMS).
Sistemi i kullimit dhe vaditjes	Aktivite ndërtimi dhe transporti;	Pronarët e tokës, Banorët vendas	Dëmtime në sistemin e kullimit dhe të vaditjes	Për tu përcaktuar	Brenda	Kuadri në lidhje me efektet e mundshme në sistemin e kullimit dhe në bujqësi
Peisazhi	Aktivite ndërtimi dhe transporti;	Banorët vendas	Ndikim në peisazh	E gjithë zona e punimeve	Jashtë	Përfituesi do të zbatojë Praktikën e Mirë Ndërkombëtare (PMN) në aktivitetet e tyre të ndërtimit si pjesë e Sistemit të tyre të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (SMMS).
Peisazhi	Funksionim	Banorët vendas	Ndikimi në peisazh nga rritja e lartësisë së	Për tu përcaktuar	Jashtë	Përfituesi do të zbatojë Praktikën e Mirë Ndërkombëtare (PMN) në aktivitetet e tyre të ndërtimit si pjesë e

Çështjet VNMS	Burimi i ndikimit	Receptorët	Ndikimi	Ndjeshmëritë e receptorëve kryesorë	Kuadri Brenda/Jashtë	Arsyetimi për kuadrin Në/Jashtë
			linjës hekurudhore			Sistemit të tyre të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (SMMS).
Peisazhi	Funksionim	Banorët vendas	Ndikim në peisazh nga ndërtimi i mbikalimeve dhe nënkalimeve të reja	Për tu përcaktuar	Jashtë	Përfituesi do të zbatojë Praktikën e Mirë Ndërkombëtare (PMN) në aktivitetet e tyre të ndërtimit si pjesë e Sistemit të tyre të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (SMMS).
Peisazhi	Funksionim	Banorët vendas	Ndikim në peisazh nga ndërtimi i barrierave të zhurmës	Në të gjithë zonën shumë të banuar	Brenda	Kuadri në lidhje me ndërtimin e barrierave të zhurmës në përputhje me mjedisin.
Bujqësia	Ndërtim dhe funksionim	Fermerët vendas	Hekurudha shërben si argjaturë për ujërat e shirave	Për tu përcaktuar	Brenda	Kuadri në lidhje me shmangien e këtij ndikimi të mundshëm negativ.
Bujqësia	Aktivitetet ndërtimi dhe transporti;	Fermerët vendas	Dëmtim i bujqësisë nga aktivitetet e ndërtimit dhe transportit	E gjithë zona e punimeve	Jashtë	Përfituesi do të zbatojë Praktikën e Mirë Ndërkombëtare (PMN) në aktivitetet e tyre të ndërtimit si pjesë e Sistemit të tyre të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (SMMS).
Përdorimi i tokës	Ndërtim dhe funksionim	Pronarët e tokës	Sipërfaqe toke e kërkuar për stacionin e Lezhës	Vendndodhja e stacionit të ri të Lezhës të propozuar	Brenda	Kuadri në lidhje me sipërfaqen e tokës që kërkohet për stacionin e ri të Lezhës
Përdorimi i tokës	Ndërtim dhe funksionim	Pronarët e tokës, banorët vendas	Sipërfaqja e tokës e kërkuar për	Për tu përcaktuar	Brenda	Kuadri në lidhje me sipërfaqen e tokës që kërkohet për rrugët e reja dytësore

Çështjet VNMS	Burimi i ndikimit	Receptorët	Ndikimi	Ndjeshmëritë e receptorëve kryesorë	Kuadri Brenda/Jashtë	Arsyetimi për kuadrin Në/Jashtë
			rrugë dytësore			
Përdorimi i tokës	Ndërtim dhe funksionim	Pronarët e tokës, banorët vendas	Sipërfaqja e tokës e kërkuar për mbikalime dhe nënkalime	Për tu përcaktuar	Brenda	Kuadri në lidhje me sipërfaqen e tokës që kërkohet për nënkalimet dhe mbikalimet e reja
Përdorimi i tokës	Ndërtim dhe funksionim	Pronarët e tokës	Kufizimet e përdorimit të tokës	Për tu përcaktuar	Brenda	Kuadri, sepse linja hekurudhore ndodhet midis tokës bujqësore dhe shtëpive
Mbetje të ngurta	Aktivitete ndërtimi	Banorët vendas	Ndikimi në peizazh; në cilësinë e mjedisit; në bujqësi	E gjithë zona e punimeve	Jashtë	Përfituesi do të zbatojë Praktikën e Mirë Ndërkombëtare (PMN) në aktivitetet e tyre të ndërtimit si pjesë e Sistemit të tyre të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (SMMS).
Mbetje të ngurta	Aktivitete ndërtimi	Banorët vendas	Ndikimi në peizazh; në cilësinë e mjedisit; në bujqësi	Shtresa fundore hekurudhore është e mbushur me material të cilësisë së dobët (km 21-25 dhe km 90-98), i cili do të zëvendësohet me material të mirë.	Brenda	Kuadri në lidhje me ndikimet në mjedis dhe vendet ku duhet të depozitohen mbetjet e ngurta
Trashëgimi kulturore	Aktivitete ndërtimi	Trashëgimia kulturore	Dëmtime të mundshme të objekteve arkeologjike	Për tu përcaktuar	Brenda	Kuadri në lidhje me sipërfaqen e tokës që kërkohet për stacionin e ri të Lezhës, rrugët dytësore dhe nënkalimet e mbikalimet
Personat vulnerabël	Ndërtim dhe funksionim	PAP vulnerabël	Vështirësi për tu kompensuar në mënyrë të drejtë	E gjithë zona e punimeve	Brenda	Kuadri në lidhje me vështirësitë që mund të përballlet kjo kategori personash për tu kompensuar në

Çështjet VNMS	Burimi i ndikimit	Receptorët	Ndikimi	Ndjeshmëritë e receptorëve kryesorë	Kuadri Brenda/Jashtë	Arsyetimi për kuadrin Në/Jashtë
			për tokën dhe jetesën			mënyrë korrekte.
Shëndeti i njerëzve	Aktivitete ndërtimi	Banorët vendas; Fuqia punëtore	Ndikim në shëndet	E gjithë zona e punimeve	Jashtë	Përfituesi do të zbatojë Praktikën e Mirë Ndërkombëtare (PMN) në aktivitetet e tyre të ndërtimit si pjesë e Sistemit të tyre të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (SMMS).

### **3.4 Shtojca 3.4: Procedura administrative dhe dokumentacioni i nevojshëm për të marrë Deklaratën Mjedisor**

Duke filluar nga Janari 2020, kërkesa për leje mjedisore do të bëhet në mënyrë elektronike nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania<sup>7</sup>.

VKM 686/2015, e ndryshuar në vitin 2019, parashikon dokumentacionin dhe afatet e nevojshme.

Afatet janë si më poshtë:

- Njoftimi për VNM-në e plotë: 45 ditë;
- Lëshimi i Deklaratës Mjedisore: 60 ditë;

Deklarata Mjedisore është e vlefshme vetëm për dy vjet. Nëse ndërtimi nuk fillon brenda dy viteve pas lëshimit të Deklaratës Mjedisore, procesi i VNMS-së duhet të rifillojë nga e para.

---

<sup>7</sup> [https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service\\_code=13278](https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13278)

## **4 Shtojcat në lidhje me kapitullin 4**

### **4.1 Shtojca 4.1: asnjë**



## 5 Shtojcat në lidhje me kapitullin 5

### 5.1 Shtojca 5.1: Ndotësit kryesorë mjedisorë të ajrit dhe burimet e ndotjes

#### *Ndotësit kryesorë të ajrit*

Sipas Agjencisë Evropiane të Mjedisit<sup>8</sup>, ndotësit e ajrit mund të kategorizohen si parësorë ose dytësorë. Ndotësit parësorë emetohen drejtpërdrejt në atmosferë, ndërsa ato dytësore formohen në atmosferë nga ndotësit prekursorë nëpërmjet reaksioneve kimike dhe proceseve mikrofizike.

Ndotësit kryesorë parësorë të ajrit përfshijnë grimcat e pluhurit (PM), karbonin e zi (BC), oksidet e squfurit (SO<sub>x</sub>), oksidet e azotit (NO<sub>x</sub>) (që përfshin si monoksidin e azotit, NO, ashtu edhe dioksidin e azotit, NO<sub>2</sub>), amoniakun (NH<sub>3</sub>), monoksidin e karbonit (CO), metanin (CH<sub>4</sub>), përbërësit organikë të paqëndrueshme pa metan (NMVOCs), përfshirë benzenin (C<sub>6</sub>H<sub>6</sub>), disa metale dhe hidrokarbure aromatike policiklike (PAHs) përfshirë benzo[a]piren (BaP).

Ndotësit kryesorë dytësorë të ajrit janë PM (i formuar në atmosferë), ozoni (O<sub>3</sub>), NO dhe disa përbërës organikë të avullueshëm të oksiduara (VOCs). Gazet kryesore prekursorë për PM dytësore janë dioksidi i squfurit (SO<sub>2</sub>), NO<sub>x</sub>, NH<sub>3</sub>, and VOCs. Gazet SO<sub>2</sub>, NO<sub>x</sub> dhe NH reagojnë në atmosferë për të formuar përbërës të sulfatit (SO<sub>4</sub>), nitratit (NO<sub>3</sub><sup>-</sup>) dhe amoniumit (NH<sub>4</sub><sup>+</sup>). Këta përbërës formojnë grimca të reja në ajër ose kondensohen në ato para-ekzistuese për të formuar PM inorganike dytësore. Disa NMVOCs oksidohen në përbërës të avullueshëm pa formë, të cilat formojnë aerosole organike dytësore. O<sub>4</sub><sup>+</sup> (troposferik) në nivelin e tokës nuk emetohet drejtpërdrejt në atmosferë. Por, formohet nga reaksionet kimike në prani të dritës së diellit, pas emetimeve të gazeve prekursorë, kryesisht NO, NMVOCs, CO dhe CH<sub>4</sub>. Këto mund të jenë me origjinë natyrore (biogjenike) dhe antropogjenike. Gjithashtu NO<sub>x</sub> në zonat me emetim të lartë varfëron ozonin troposferik si rezultat i reaksionit të titrimit me NO të emetuar për të formuar NO<sub>3</sub> dhe oksigjenin.

#### *Burimet kryesore të ndotjes*

Sipas Agjencisë Evropiane të Mjedisit, burimet e substancave kryesore që ndotin ajrin e mjedisit janë si më poshtë<sup>9</sup>:

- PM<sub>10</sub> dhe PM<sub>2.5</sub>: grimcat parësore (PM) e kanë origjinën si nga burimet natyrore ashtu edhe nga ato antropogjene, dhe zakonisht klasifikohen si PM<sub>10</sub> parësore ose PM<sub>2.5</sub> parësore. Burimet natyrore përfshijnë kripën e detit, pluhurin natyror pezull, polenin dhe hirin vullkanik, ndërsa burimet antropogjene përfshijnë djegien e karburantit për prodhimin e energjisë, për ngrohjen e shtëpive dhe transportin, industrinë dhe djegien e mbeturinave, dhe bujqësinë, si dhe frenat, gomrat dhe veshjet e rrugëve dhe lloje të tjera të pluhurit antropogjen. Karboni i zi është një përbërës i PM<sub>2.5</sub> i formuar nga djegia jo e plotë e karburantit, me burimet kryesore që përfshijnë transportin dhe ngrohjen e shtëpive.
- BaP (benzo[*a*]pyrene): gazi i emetuar si rezultat i djegies jo të plotë të lëndëve djegëse fosile dhe biokarburanteve. Burimet kryesore të BaP janë ngrohja e shtëpive (në

<sup>8</sup> <https://www.eea.europa.eu/publications/air-quality-in-europe-2019>

<sup>9</sup> <https://www.eea.europa.eu/publications/air-quality-in-europe-2017>

veçanti djegia e drurit dhe qymyrit), djegia e mbetjeve, prodhimi i koksit dhe prodhimi i çelikut. Burime të tjera përfshijnë zjarret në natyrë, trafikun rrugor dhe konsumimin e gomave të makinave.

- $NO_x$ : burimet kryesore të oksideve të azotit ( $NO_x$ ) janë proceset e djegies, të cilat mund të jenë ose të palëvizshme ose të lëvizshme. Oksidi nitrik (NO) përbën shumicën e emetimeve të  $NO_x$ : NO më pas oksidohet për të formuar  $NO_2$ , megjithëse një pjesë e  $NO_2$  emetohet drejtpërdrejt. Përpjestimi i  $NO_2$  (d.m.th. raporti  $NO_2 / NO_x$ ) në shkarkimin e automjeteve është dukshëm më i lartë në automjetet me naftë sesa në automjetet me benzinë, sepse sistemet e tyre të trajtimit të mëposhëm të shkarkimit rrisin oksidimin e NO, duke gjeneruar kështu emetime më të larta të  $NO_2$  direkte.

Duke u bazuar në sa më sipër, mund të supozohet që cilësia e ajrit përgjatë linjës hekurudhore ndikohet kryesisht nga trafiku dhe aktivitetet e ndërtimit.

Përveç kësaj, cilësia e karburanteve të përdorura për motorët e transportit dhe të punës nuk është gjithmonë brenda standardeve të kërkuara dhe për këtë arsye djegia e karburantit është burim për BaP dhe  $NO_x$ .

Duhet theksuar që përmirësimi i cilësisë së rrjetit rrugor dhe ulja e ndërtimit të ndërtesave të reja do të kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së ajrit. Bumi i aktiviteteve ndërtimore tashmë është pothuajse i ndalur dhe po përmirësohet infrastruktura rrugore brenda zonave të reja të urbanizuara.

## 5.2 Shtojca 5.2: Llojet e tokës (nëntokës) në përputhje me eurokodin 8

Në përputhje me Eurokodin 8 (§3.1.2), ekzistojnë pesë lloje tipike të tokës/dheut (A, B, C, D, E) dhe 2 lloje të veçanta të tokës (S1, S2) që mund të përdoren për të llogaritur ndikimin e kushtet lokale të tokës në veprimin sizmik. Shpejtësia mesatare e valës prerëse në 30 m e parë nga sipërfaqja llogaritet sipas ekuacionit të mëposhtëm equation: (EC8 § 3.1.2 (3))

$$v_{s,30} = \frac{30}{\sum_{i=1}^N \frac{h_i}{v_i}}$$

ku

hi dhe vi tregojnë trashësinë (në metra) dhe shpejtësinë e valës së prerjes (në një nivel deformimi prerës 10-5 ose më pak) për formimin ose shtresën i, në një total.

Nëse vlera of  $v_{s,30}$  nuk është e disponueshme, mund të përdoret numri e blloqeve për 0.3 m në testin NSPT . Nëse nuk është i disponueshëm as ky numër, mund të përdoret cu. Tabela e mëposhtme paraqet përshkrimin e çdo lloji terreni dhe parametrat e përkufizimit.

Tabela 5.1\_ Llojet e tokës/terreneve në përputhje me Eurokodin 8 (EC8 § 3.1.2 Tabela 3.1)

Lloji i tokës dhe përshkrimi	$v_{s,30}$	N <sub>SPT</sub>	Cu
<b>A:</b> Shkëmb ose formacione të tjera gjeologjike të ngjashme me shkëmbinjtë, duke përfshirë më së shumti 5 m material më të dobët në sipërfaqe	>800	-	-
<b>B:</b> Depozitime të rërës shumë të dendur, zhavorrit ose argjilës shumë të ngurtë, të paktën disa dhjetëra metra	360-	>50	>250

trashësi, të karakterizuara nga një rritje graduale e vetive mekanike me thellësinë.	800		
<b>C:</b> Depozitime të thella të rërës së dendur ose mesatarisht të dendur, zhavorrit ose argjilës së ngurtë me trashësi nga disa dhjetëra në shumë qindra metra.	180-360	15-50	70-250
<b>D:</b> Depozitime të dheut pa kohezion nga i shkrifët deri në mesatarisht (me ose pa disa shtresa të buta kohezive), ose të tokës kohezive kryesisht të butë në të ngjeshur.	<180	<15	<70
<b>E:</b> Profil dheu i përbërë nga një shtresë aluvionale sipërfaqësore me vlera vs të llojit C ose D dhe trashësi që varion midis rreth 5 m dhe 20 m, e mbuluar nga materiali më i fortë me vs > 800 m/s.			
<b>S<sub>1</sub>:</b> Depozitime të përbëra ose që përmbajnë një shtresë të paktën 10 m të trashë, prej argjile/llumrash të buta me një indeks të lartë plasticiteti (PI > 40) dhe përmbajtje të lartë uji	<100	-	10-20
<b>S<sub>2</sub>:</b> Depozitime të tokave të lëngëzueshme, të argjilave të ndjeshme ose të çdo profili tjetër toke që nuk përfshihet në llojet A – E apo S <sub>1</sub>			

### 5.3 Shtojca 5.3: informacionet bazë për habitatet dhe llojet në ruajtje

#### 5.3.1 Hyrje

Analiza e mëposhtme është bërë në përputhje me Kërkesën 6 të Performancës së BERZH-it: Ruajtja e biodiversitetit dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore të gjalla.

Kjo Kërkesë e Performancës (KP) bazohet në tre parime kryesore:

1. Kjo KP pranon që ruajtja e biodiversitetit dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore të gjalla janë thelbësorë për qëndrueshmërinë mjedisore dhe sociale.
2. Kjo KP njeh rëndësinë e ruajtjes së funksionit thelbësor ekologjik të habitateve, të biodiversitetit dhe të shërbimeve të ekosistemit. Të gjitha ekosistemet mbështesin një tërësi të organizmave të gjallë dhe ndryshojnë në aspektin e pasurisë, bollëkut dhe rëndësisë së llojeve .
3. Objektivi i ruajtjes së biodiversitetit dhe i menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve të gjalla duhet të balancohet me potencialin për shfrytëzimin e vlerave të shumta ekonomike, sociale dhe kulturore të biodiversitetit dhe burimeve natyrore të gjalla në mënyrë të optimizuar.

Duke u bazuar në sa më sipër, qëllimi kryesor i kësaj analize është përcaktimi i tipareve prioritare të biodiversitetit dhe i habitateve kritike në zonën e ndikimit të projektit.

Duke qenë se hekurudhat kalojnë kryesisht nëpër toka të punueshme, kjo analizë u krye kryesisht për zonat me ndjeshmëri ekologjike, duke përfshirë seksionet e lumenjve që përshkohen nga linja hekurudhore, si dhe zonat me rëndësi ruajtjeje si Rezervat e Menaxhuar Natyrore të Liqenit të Shkodrës, Zona Ramsar Liqeni i Shkodrës- Lumi Buna, Zona e Rëndësishme e Shpendëve të Liqenit të Shkodrës, Zona kryesore e Biodiversitetit të Bunës së Shkodrës dhe Zona Kandidate për Smerald e Liqenit të Shkodrës.

### 5.3.2 Metodologjia

Qasja e vlerësimit të biodiversitetit bazohet në Kërkesën 6 të Performancës së BERZH-it: Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Burimeve Natyrore të Gjalla.

#### 5.3.2.1 EBRD KP 6 dhe “karakteristikat prioritare të biodiversitetit”

Në përputhje me paragrafin 12 të KP 6 të BERZH-it, disa zona të prekura nga Projekti mund të konsiderohen si “tipare prioritare të biodiversitetit”, të cilat përfshijnë:

- i. habitatet e kërcënuara;
- ii. llojet vulnerabël;
- iii. karakteristikat e rëndësishme të biodiversitetit të identifikuara nga një grup i gjerë aktorësh ose qeverish (të tilla si Zonat e Rëndësishme të Zogjve, Zonat kryesore të Biodiversitetit); dhe
- iv. strukturat dhe funksionet ekologjike të nevojshme për të ruajtur qëndrueshmërinë e karakteristikave prioritare të biodiversitetit të përshkruara më sipër.

PR6 e BERZH përcakton në mënyrë specifike “habitatet kritike” si tiparet më të ndjeshme të biodiversitetit, të cilat përfshijnë një nga sa më poshtë:

- i. ekosisteme unike ose tepër të kërcënuara;
- ii. habitatet me rëndësi të konsiderueshme për llojet në zhdukje ose të rrezikuara në mënyrë kritike;
- iii. habitatet me rëndësi të konsiderueshme për llojet endemike ose të kufizuara gjeografikisht;
- iv. habitatet që mbështesin llojet migratore ose habitate të rëndësishme në nivel global; ose
- v. fushat që lidhen me proceset kyçe të evolucionit.

Analiza dhe vlerësimi i biodiversitetit mbulon sa më poshtë:

- Rishikon të gjithë dokumentacionin përkatës ekzistues, informacionin bazë mbështetës dhe çdo raport tjetër/grup të dhënash përkatës për të vlerësuar përshtatshmërinë e këtij informacioni;
- Duke u bazuar në informacionin ekzistues, plotëson një ekzaminim të veçorive të Habitatit Kritik/Karakteristikave prioritare për Biodiversitetin në mënyrë që të ndihmojë për identifikimin nëse (i) habitatet dhe/ose llojet me rëndësi ruajtje mund të ndikohen nga Projekti dhe (ii) kërkohen studime shtesë bazë. Gjithashtu do të identifikohet nëse ka ndonjë mangësi tjetër materiale brenda vlerësimit ekzistues të ndikimit të biodiversitetit që duhet të adresohet;
- Kriteret për identifikimin e karakteristikave kryesore të biodiversitetit.

#### 5.3.2.2 Kriteret për identifikimin e karakteristikave të biodiversitetit

Kriteret e mëposhtme janë propozuar për të identifikuar tiparet kryesore të biodiversitetit (habitatet dhe llojet).

**Habitatet:**

- Janë përfshirë në Direktivën e BE-së për Habitatet – Shtojca 1 Habitatet prioritare.

- Habitatet bazë dhe të përshtatshme për llojet që plotësojnë kriteret e treguara më poshtë:

**Llojet:**

- Të listuara në Direktivën e BE-së për Zogjtë (Aneks 1, 2.1 dhe 2.2);
- Konventa e Bernës (Konventa për Ruajtjen e Kafshëve të Egra Evropiane dhe Habiteteve Natyrore – Aneks I, II dhe III);
- Konventa CITES (Konventa për Tregtinë Ndërkombëtare të Llojeve të Rrezikuara të Faunës dhe Florës së Egër – Aneks I, II dhe III);
- Përfshirë në Listën e Kuqe të IUCN në nivel global;
- Përfshirë në Listën e Kuqe të IUCN në nivel evropian;
- Llojet e kërcënuara në nivel mesdhetar (sipas kriterëve të IUCN);
- Përfshirë në Direktivën e BE-së për Habitatet (Shtojcat 2, 4 dhe 5), me paraqitjen e çdo lloje prioritare (lloje prioritare nënkupton llojet për ruajtjen e të cilave Komuniteti ka përgjegjësi të veçantë në funksion të proporcionit të shtrirjes së tyre natyrore që bie brenda territorit të referuar në nenin 2, këto lloje prioritare tregohen me një yll (\*) në aneksin II);
- Llojet e përfshira në Listën e Kuqe Kombëtare (me status IUCN); dhe
- Llojet endemike kombëtare apo rajonale (ballkanike).

### **5.3.3 Informacionet bazë për pellgun ujëmbledhës të Liqenit të Shkodrës dhe rezervatin natyror të menaxhuar**

Liqeni i Shkodrës dhe pellgu ujëmbledhës i tij përfaqësojnë një kompleks habitatesh me diversitet të lartë organizmash të gjallë. Këto karakteristika lidhen me regjimin ujqor, i cili ndryshon sipas stinëve dhe me luhatjet e vëllimit të ujit.

#### **5.3.3.1 Banorët dhe Bimët**

##### **Habitatet ujore dhe Bimët**

Pellgu ujëmbledhës i Liqenit të Shkodrës ka tre sisteme kryesore të habitateve ujore:

- sistemi i habitatit liqenor;
- sistemi i habitatit moçalor; dhe
- sistemi lumor/i përrenjve.

Deri tani njihen 60 bashkësi bimore: 6 bashkësi janë të Scirpeto – Phragmitetum, 4 bashkësi janë të *Najadetum marina*, *Nymphoidetum peltatae*, *Nympheetum albo*, *Sparganio - Glicerietum fluitantis*.

*Najadetum marina*, *Nymphoidetum peltatae*, *Nympheetum albo*, *Sparganio -Glicerietum fluitantis*.

Numri më i lartë i llojeve është nga bashkësitë e *Potametum perfoliati* të gjendura ndërmjet 1-3m, *Nympheetum albo-lutea*, *Sparganio – Glicerietum fluitantis* dhe *Scirpeto – Phragmitetum*.

Një nga komunitetet më të rëndësishme të algave të zhytura në liqenin e Shkodrës janë Charophytes or Stoneworts (Charales, Characeae). Ky komunitet ka një rëndësi të madhe për qëndrueshmërinë mjedisore dhe ekonomike të ekosistemit ujqor të liqenit të Shkodrës.

### Habitatet tokësore dhe bimët

Habitatet tokësore dhe bimët e pellgut ujëmbledhës të Liqenit të Shkodrës janë si më poshtë:

Zona Pyjore ndodhet deri në 400 – 500 m mbi nivelin e detit. Pemët dhe shkurret më të zakonshme në këtë zonë janë *Quercus ilex*, *Phillyrea latifolia*, *Juniperus oxycedrus*, *Erica arborea* etj.

Zona e Dushkut ndodhet midis 300-700 m mbi nivelin e detit dhe njihet për llojet e mëposhtme: *Quercus trojana*, *Quercus cerris*, *Quercus petraea*, *Quercus frainetto*, *Quercus pubescens* etj.

Zona e Ahut ndodhet midis 600 - 1700 m mbi nivelin e detit, e cila së bashku me nënzonën halore arrin 1900 m. Llojet më të zakonshme janë *Fagus silvatica*, *Acer pseudoplatanus*, *Sorbus graeca* and shrubs *Cotoneaster integerrimus*, *Rubus idaeus*, *Vaccinium myrtillus* etj.

Kullotat alpine Kullotat alpine ndodhen midis 1800 -1900 m mbi nivelin e detit. Disa gjini dhe lloje të këtyre kullotave janë *Rosa sp.*, *Juniperus sabina*, *Salix retusa*, *Poa sp.*, *Festuca sp.*, *Sesleria sp.*, *Luzula italica*, *Bromus sp.*, *Koeleria sp.*, *Gentiana verna*, *Gentiana lutea*, *Astragalus purpureus*, *Anthyllis aurea*, *Campanula sp.*, *Silene macrantha*.

#### 5.3.3.2 Fauna e Liqenit dhe e pellgut të tij ujëmbledhës

##### Jovvertebrorët

Liqeni i Shkodrës karakterizohet nga një diversitet relativisht i lartë i llojeve të jovvertebrorëve. Kjo lidhet me diversitetin e habitateve dhe mikrohabitateve në liqen, të bimëve dhe algave, si dhe tipologjive të nënshtresave. Në liqen janë sinjalizuar më shumë se 450 lloje jovvertebrorësh ujorë, përveç protozoarëve dhe rotiferëve.

Knidarianët (Cnidaria): përfaqësohen nga dy lloje, nga të cilat njëra është autoktone, Hidra kafe *Hydra oligactis* dhe një lloje e huaj, kandil deti i ujërave të ëmbla *Craspedacusta soërbii*.

Sfyngjerët (Spongia): ato përfaqësohen vetëm nga një lloj, *Spongilla lacustris*.

Krimbat e sheshtë (Platyhelminthes): Njihen 31 lloje nga të cilat 6 Cestods dhe 25 Trematods (parazitë të peshqve dhe shpendëve të ujit).

Nematodat (Nematoda): Në liqen janë sinjalizuar 11 lloje parazitare.

Rotiferët (Rotifera): Janë sinjalizuar 51 lloje planktonike dhe bentike, ku mbizotërojnë familjet Brachionidae, Gastropodidae, Lecanidae, Synchaetidae dhe Trichocercidae.

Acanthocephalan (Acanthocephala): Në liqen njihen 7 lloje parazitare.

Molusqet (Mollusca): lista e molusqeve të Liqenit të Shkodrës dhe të trupave ujorë përreth (burimet, ligatinat, ujërat nëntokësore) përfshin 91 lloje. 76 lloje janë gastropodë (kërmijtë) dhe 15 lloje janë dyvalvore (midhjet).

Familjet më të pasura në numrin e llojeve janë Hydrobiidae (26), Planorbidae (19), Lymnaeidae (13), Sphaeriidae (7) dhe Unionidae (7). Janë gjetur 65 lloje në liqen, në burimet e tij nënujore, në pellgjet me lidhje direkte me liqenin, në pjesën më të ulët të degëve të liqenit dhe në pjesën e sipërme të lumit Buna. 26 llojet e tjera janë gjetur në burimet dhe ujërat nëntokësore të lidhura me liqenin. 28 lloje molusqesh janë endemike të Liqenit të Shkodrës dhe të habitateve ujore të lidhura me të.

Bryozoans (Bryozoa): ato përfaqësohen nga dy lloje në liqen, *Plumatella repens* dhe *Cristatella mucedo*. Ato janë forma koloniale dhe rriten të ngjitura tek bimësia ujore, gurët, si dhe tek nënshtresat e forta organike apo artificiale.

Oligochaetes (Oligochaeta) – krimbat anelidë: Deri tani janë regjistruar gjithsej 35 lloje Oligochaeta në liqenin e Shkodrës. U përkasin familjeve Naididae, Lumbriculidae dhe Criodrilliidae. Midis tyre, tre lloje janë endemike të Liqenit të Shkodrës: *Spirosperma scodraensis*, *Tubificidarum hrabei*, dhe *Trichodrilus montenegrinus*.

Shushunjat (Hirudinea): shushunjat i përkasin një grupi tjetër të kimbave anelidë dhe përfaqësohen nga 15 lloje në liqenin e Shkodrës. Shumica e llojeve të shushunjeve banojnë në liqen, por disa lloje janë sinjalizuar vetëm në mjediset nënujore (*Glossiphonia paludosa*, *Glossiphonia pulchella*). Pranë burimeve banojnë dy lloje *Dina dinarica* dhe *Trocheta dalmatina*.

Krostacët (Crustacea): Në liqen janë sinjalizuar të paktën 110 lloje krustacesh, nga të cilat 34 janë Malacostraca. Cladocera, Amphipoda dhe Copepoda janë grupet me numrin më të madh të llojeve. Dekapodët përfaqësohen nga 8 lloje: *Astacus astacus*, *Austropotamobius torrentium*, *Austropotamobius italicus meridionalis*, *Atyaephyra desmaresti*, *Palaemonetes antennarius*, *Potamon fluviatile*, *Troglocaris prasence* dhe *Troglocaris hercegovinensis*. Brankiopodët janë grupi më i pasur me 36 lloje, nga të cilat 22 janë nga familja Euryceridae. Njihën 22 lloje të Ostrakodës nga të cilat 11 i përkasin familjes Candonidae. Kopepodët përfaqësohen nga 18 lloje, nga të cilat 11 i përkasin familjes Cyclopedidae. Problemet me sinonimet e e taksoneve nuk janë zgjidhur plotësisht dhe lista e llojeve të krustaceve të liqenit të Shkodrës nuk është ende përfundimtare, gjë që e bën të vështirë përcaktimin e llojeve endemike. Megjithatë, është thënë qartë që 12 lloje të Malacostraca janë endemike të Liqenit, një i përket Mysidacea, një Isopodës dhe 10 Amfipodës, nga të cilat 8 lloje i përkasin gjinisë *Niphargus* (*N. asper*, *N. brevicuspis sketi*, *N. inclinatus*, *N. maximus vulgaris*, *N. podgoricensis*, *N. vranjine*, *N. zorae*, *N. kusceri*).

Insektet (Insecta): Përfaqësojnë një grup mjaft interesant të liqenit të Shkodrës. Deri tani, nuk është bërë asnjë studim i plotë për insektet e pellgut ujëmbledhës të Liqenit të Shkodrës. Renditja sipas numrit më të madh të llojeve është Coleoptera, Lepidoptera, Hymenoptera, Diptera, Hemiptera dhe Orthoptera. Pjesa më e madhe e tyre përfaqësohet nga llojet që kanë një fazë bentonike të larvave. Më poshtë jepen disa shifra nga grupet më të studiuara të insekteve në liqenin e Shkodrës dhe në ujëmbledhësin e tij. Janë regjistruar 35 lloje Ephemeroptera (Mayflies), 60 lloje Plecoptera (stoneflies) dhe 55 lloje Trichoptera. 60 lloje Odonata (pilivesa), nga të cilat 23 në ujëmbledhësin e liqenit dhe 14 lloje janë në rrezik në nivel evropian dhe mesdhetar. Në Liqenin e Shkodrës dhe trupat ujqorë të lidhur me të janë të njohur Coleoptera (brumbujt), 14 lloje brumbujsh zhytës (Dytiscidae), 1 lloj brumbujsh ujit gjermues (Noteridae) dhe 1 lloje brumbujsh rrotullues (Gyrinidae) (*Orectochilus villosus*). Në përrrenjtë përreth mund të gjenden Elmidae dhe Hydraenidae, disa prej të cilave, si *Ochthebius insidiosus* (Hydraenidae) i përshkruar nga Rijeka Crnojevića, janë endemike. Në liqen, Hemipterët janë të përfaqësuara me 10 lloje. Mizat e vërteta (Diptera) janë një nga grupet më të rëndësishme dhe më të larmishme të faunës së makroinvertebroreve bentonike. Në Liqenin e Shkodrës dhe në trupat ujqorë përreth tij janë të njohura më shumë se 20 familje. Chironomidae (mizat e vogla) përfaqësohen me 31 lloje mizash jo-pickuese nga vetë liqeni dhe 24 lloje nga burimet. Studimet më të fundit supozojnë që ky numër është një nënvlerësim dhe se diversiteti taksonomik i mizave jo-pickuese në pellgun e Liqenit është shumë më i lartë. Ky fenomen mund të shkaktohet nga shfaqja e llojeve të fshehta në disa gjini ose rrallë nga identifikimi i gabuar midis taksoneve morfologjikisht të ngjashme. Kulicidet (mushkonjat) përfaqësohen nga disa lloje, nga të cilat disa janë vektorë të mundshëm të malarisë (*Anopheles saccharovi*, *Anopheles maculipennis*), virusi chikungunya dhe virusi dengue (*Aedes albopictus*), dhe virusi i Nilit Perëndimor dhe virusi i etheve të Luginës së Riftit (*Culex pipiens*). Kohët e fundit, në basenin e liqenit të Shkodrës është sinjalizuar mushkonja tigër aziatike (*Aedes albopictus*).

## **Vertebrorët**

**Peshqit (Pisces):** Ihtiofauna e Liqenit të Shkodrës përbëhet nga 59 lloje që i përkasin 18 familjeve (17 prej të cilave janë vendase), duke përfshirë llojet diadrome, euryhaline dhe llojet e futura. Prej tyre, 44 janë vendase të pellgut ujëmbledhës, ndërsa 15 janë futur. Shtatë lloje janë endemike: *Ninnigobius montenegrensis*, *Knipoëitschia montenegrina*, *Barbatula zetensis*, *Rutilus albus*, *Gobio skadarensis*, *Salmo zetensis* dhe *Chondrostoma scodrense* – e zhdukur. Familja më e larmishme është Cyprinidae me 24 lloje (nga të cilat 16 janë vendase), e ndjekur nga Mugillidae (5) dhe Gobiidae (4). Peshqit në liqenin e Shkodrës dhe në pellgun ujëmbledhës të tij kanë potencial të konsiderueshëm ekonomik. Llojet e mëposhtme peshkohen për qëllime tregtare: Gjuhca (*Alburnus scoranza*), Krapa (*Cyprinus carpio*), Karasi i artë (*Carassius auratus*), Ngjala (*Anguilla anguilla*), lloska e Shkodrës (*Scardinius knezevici*), Mëlyshi i Shkodrës (*Squalius platyceps*), Njila e Ohrit (*Chondrostoma ohridanum*), Skorta i bardhë (*Rutilus albus*), Skorta e zezë (*Pachychilon pictum*), Skorta e Prespës (*Rutilus prespensis*), të gjitha llojet Mugilidae, Alosa sp., Lëvrecku (*Dicentrarchus labrax*), Sharroku (*Perca fluviatilis*) dhe ushonjëzat e zeza (*Pleuronectes flesus*).

Për sa i përket statusit të ruajtjes së tyre (pas kategorive të IUCN), numri më i madh i llojeve të peshqve (30,5%) kanë statusin LC, por një e treta e llojeve bën pjesë në një kategori të caktuar rreziku (33,3%), dhe bëhet fjalë kryesisht për ato lloje endemike të pellgut ujëmbledhës të Adriatikut. Tre lloje (5.1%) janë klasifikuar si në rrezik zhdukje (CR), dhe tre të tjera (5.1%) janë lloje të rrezikuara (EN), ndërsa katër (6.8%) janë vulnerabël (VU).

**Amfibët (Amphibia):** 15 lloje amfibësh janë sinjalizuar nga Liqeni i Shkodrës dhe degët e tij. 6 prej këtyre llojeve janë nga familja Ranidae (*Pelophylax kurtmuelleri*, *Pelophylax ridibunda*, *Pelophylax shqiperica*, *Rana dalmatina*, *Rana graeca*, *Rana temporaria*). 5 lloje janë amfibët me bisht të familjes Salamandridae (*Lissotriton vulgaris*, *Mesotriton alpestris*, *Triturus karelini*, *Salamandra salamandra*, *Salamandra atra*). 2 lloje i përkasin familjes Bufonidae (*Bufo bufo* and *Bufo viridis*), një lloj i përket familjes Bombinatoridae (*Bombina variegata*) dhe një lloj i përket Familjes Hylidae (*Hyla arborea*). Nga këto lloje, 9 janë gjetur në liqen, ndërsa 6 llojet e tjera janë sinjalizuar në pellgun ujëmbledhës të liqenit.

Për sa i përket statusit të tyre të rrezikuar në nivel evropian, 14 lloje kanë statusin LC, ndërsa një lloj (*Pelophylax shqiperica*) ka statusin EN.

**Reptilianët (Reptilia):** 36 lloje zvarranikësh janë raportuar nga liqeni i Shkodrës dhe pellgu i tij ujëmbledhës. Brenda liqenit janë gjetur 4 lloje (*Emys orbicularis*, *Mauremys rivulata*, *Natrix natrix*, *Natrix tessellata*), ndërsa të tjerat në pellgun e liqenit. 3 lloje janë breshkat (që i përkasin llojit Chelonia të familjeve Testudinidae dhe Emydidae), 18 lloje i përkasin llojit Sauria dhe 15 lloje i përkasin llojit Serpentes. Llojet më të zakonshme i përkasin familjeve Gekkonidae, Lacertidae, Anguidae, Typhlopidae, Colubridae dhe Viperidae. Vetëm dy lloje zvarranikësh janë të rrezikuar në nivel global, përkatësisht *Dinarolacerta mosorensis* dhe *Vipera ursinii*, që të dyja kanë statusin VU. Asnjë prej tyre nuk ndodh në zonën e ndikimit të projektit.

